




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME



*STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË TURIZMIT
RURAL NË KOMUNËN E SHTIMES*

2015 - 2019



SHTIME 2015

PËRMBAJTJA

Fjala e Kryetarit të Komunës së Shtimes z. Naim Ismajli.....	3
HYRJE	4
Çfarë është dhe çfarë përfaqëson Strategjia Zhvillimore për Komunën Shtime?.....	4
Pozicioni dhe ndarja e Komunës së Shtimeve sipas vendbanimeve.....	5
Infrastruktura	6
Struktura Ekonomike	6
Bujqësia dhe blegtoria	8
Arsimi	8
Kultura dhe Sporti	9
Shëndetësia	10
Indikatorët mjedisor	10
Legjislacioni kryesor dhe ai sekondar për fushën gjegjësisht sektorin e turizmit	10
LIGJI NR. 04/L-045 PËR PARTNERITET PUBLIKO PRIVAT	11
<i>DIREKTIVA Nr. 4/2012 për Publikime të Njoftimeve PPP</i>	11
<i>DIREKTIVË NR. 2 / 2011 Për Ekipet për Menaxhimin e Projekteve</i>	11
METODOLOGJIA E PERDORUR	11
VENDIM.....	12
Takim pune me grupin punues dhe përgjegjësit komunal	13
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KOMUNËS SË SHTIMES	14
ORGANIGRAMI I KOMUNES SE SHTIMES	15
PROFILI TURISTIK I KOMUNËS SË SHTIMES	17
Atraksionet turistike natyrore	18
Pamje atraktive nga "Gryka e Llanishtit"	18
Zonë e rekreative në qytetin e Shtimes me sipërfaqe prej 15ha dhe sheshet në qytetin e Shtimes	19
Pllakë përkujtimore kushtuar Ahmet Shtimes dhe Rexhep Muratit në grykë të Topillës	21
Toka dhe mundësia e shfrytëzimit për turizëm rural	22
Shpërndarja e aktiviteteve hoteliere në komunën e Shtimes	22
Problemet dhe sfidat e identifikuara zhvillimore	23
II. - SWOT Analiza e sektorit të turizmit rural në Komunën e Shtimes	23
DEKLARATA E VIZIONIT DHE MISIONIT	24
VIZIONI	24
MISIONI:	24
<i>"Zgjerimi, mbështetja dhe rritja e ofertës turistike në zonat rurale të Komunës së</i>	24
Burimet e turizmit rural dhe infrastruktura	25
Ndikimi mjedisor i turizmit rural	26
Drejtimet strategjike	26
VLËRESIMI I KAPACITETEVE INVESTUESE	26
Turizmi rural në Komunën e Shtimes- sfidat, problemet dhe mundësitë	27
Synimet dhe zgjidhjet strategjike për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit rural në	29
Komunën e Shtimes	29
BENEFITET NGA TURIZMI RURAL NË KOMUNEN E SHTIMES	31
OBJEKTIVAT STRATEGJIKE NË FUSHËN E TURIZMIT RURAL TË KOMUNËS SË SHTIMES	33
LISTA E PROJEKTEVE DHE LIDHJA ME OBJEKTIVAT, AFATET DHE PALËT E INTERESIT	35
Monitorimi	40
Vlerësimi	40
ANNEX	40

Fjala e Kryetarit të Komunës së Shtimes z. Naim Ismajli

Të dashur qytetarë të Komunës së Shtimes,

Komuna e Shtimes karakterizohet me vlera të theksuara turistike rurale, kulturore dhe natyrore. Duke u bazuar në strategjinë e zhvillimit ekonomik dhe duke pasur parasysh mundësitë që ofron Komuna e Shtimes në sektorin e turizmit rural, ne kemi identifikuar këtë sektor si një degë të rëndësishme të zhvillimit të ardhshëm me mundësitë që ofron në krijimin e vendeve të reja të punës dhe zhvillimin e ekonomisë lokale me theks te veçante në zonat rurale dhe malore.

Kjo strategji paraqet një dokument shumë të rëndësishëm për komunën dhe perspektivën e saj, pasi që në vete përmban përshkrimin e gjendjes ekzistuese, analizën ekonomike, objektivat dhe projektet konkrete prioritare për fushat specifike, burimet financiare dhe kohën (afatet) e realizimit të tyre.

Strategjia është produkt i iniciativës lokale dhe është përkrahur nga eksperti i angazhuar nga CDF Dr. Ibrahim Krasniqi me mbështetje nga grupi i gjere i punës themeluar nga Kryetari i Komunës duke u bazuar në konsultat dhe punëtoritë e zhvilluara, gjithmonë në potencialin e lokalitetit.

Plani strategjik ka për qëllim kryesor identifikimin e mundësive dhe krijimin e kushteve të volitshme për zhvillim e turizmit rural, të cilët do të kontribuonin në zhvillim ekonomik lokal. Grupit punues themeluar nga Kryetari i Komunës për hartimin e kësaj strategjie i është dhënë mbështetje e plotë politike.

Dua të shfrytëzoj këtë rast që t'i shpreh mirënjohjen time grupit punues për këtë bashkëpunim të frytshëm në përgatitjen e dokumentit. Gjithashtu dua t'u shpreh mirënjohjen time të gjithë partnerëve të tjerë dhe qytetarëve të përkushtuar për kontributin e tyre dhe vullnetin e treguar për t'u përfshirë drejtpërsëdrejti në përgatitjen dhe zbatimin e këtij dokumenti strategjik. Strategjia për zhvillimin e turizmit lokal do të jetë kuadri i veprimtarisë për institucionin tonë, duke e drejtuar zhvillimin e turizmit rural drejt objektivit të rritjes së përdorimit të qëndrueshëm të burimeve tona.

Ky dokument përcakton projektet dhe veprimet që do të ndërmarrim në të ardhmen së bashku për ta kthyer dhe avancuar Shtimen si një destinacion turistik vendor dhe regjional, me cilësi të lartë dhe shumë të njohur në zhvillimin e turizmit rural.

Në këtë mënyrë ne zotohemi për te krijuar parakushte për një zhvillim të balancuar shoqëror - ekonomik, fizik (infrastrukturor), mjedisor dhe institucional të komunës duke involvuar në proces të gjithë pjesëtarët e komunitetit lokal.

Me respekt!
Naim Ismajli
Kryetar i Komunës së Shtimes

HYRJE

Përkufizimi i politikës dhe strategjisë së zhvillimit të turizmit - Pse duhet të hartojmë një strategji për zhvillimin e turizmit rural në nivel lokal për Komunën e Shtimes.

Strategjitë paraqesin parimet, qëndrimet dhe kriteret bazë mbi të cilat merret dhe zhvillohet procesi i hartimit të vendimeve në drejtimin të zhvillimit të ardhshëm. Strategjia e zhvillimit të turizmit rural në komunën e Shtimes do të thotë një rritje kualitative e institucioneve të saj, respektivisht, aktiviteteve të komunës në tërë territorin. Strategjia përfshin hartimin e vizionit dhe misionit të komunës, qëllimet strategjike në nivel lokal dhe me gjere - zhvillimin e strategjisë së turizmit rural me impakt ekonomik dhe zhvillimin e infrastrukturës dhe institucioneve.

Kjo strategji është përgatitur me ndihmën nga eksperti i angazhuar nga CDF Dr. Ibrahim Krasniqi me mbështetje nga grupi i punës themeluar nga Kryetari i Komunës z.Naim Ismajli dhe bazuar në konsultat dhe punëtoritë e zhvilluara.

Strategjia është një hartë për t'u ndjekur nga të zgjedhurit, personeli i komunës dhe komuniteti në tërësi për ti dhënë formë të ardhmes së dëshiruar prej tyre. Kjo ka të bëjë me të menduarin, të vepruarin dhe parashikimin strategjik të veprimeve që duhet të ndërmerrem në mënyrë që të realizojmë qëllimet e dëshirueshme.

Qëllimet strategjike dhe hapat e veprimit të shprehura në Strategjinë e zhvillimit të turizmit rural nuk janë vetëm autoriteti i qeverisjes vendore. Komuna nuk mund të bëjë vetë gjithçka dhe as nuk mund t'i adresojë vetëm të gjitha problemet. Kështu që, në këtë është ide që i gjithë komuniteti ka një kontribut për të dhënë në arritjen e zhvillimit të turizmit rural dhe zhvillimit të një komune të qëndrueshme. Angazhimi dhe veprimet e komunitetit, grupeve dhe të interesuarve të tjerë janë mjaft të rëndësishme në arritjen e suksesshme të Vizionit të Komunës, qëllimeve dhe veprimeve që janë themelore në Strategjinë zhvillimore të turizmit rural. Një Strategji është efektive kur në mënyrë rigoroz përdoret që të planifikojë shërbime dhe projekte, identifikojë burimet, boshllëqet dhe nevojat financiare, të masë rezultatet e punës së qeverisë lokale dhe t'i komunikojë këto rezultate tek komuniteti. Ky është një proces dhe dokument me anë të të cilit qytetari mund të vërë përpara përgjegjësisë të të zgjedhurit në mënyrë që ti përgjigjet nevojave dhe prioriteteve të tij. Strategjia e zhvillimit të turizmit lokal siguron një përdorim efektiv të burimeve specifike turistike rurale, kulturore, historike dhe natyrore brenda territorit të komunës në mënyrë që të mbështet zhvillimin e qëndrueshëm dhe të bëhet sa më e mundur arritja e objektivave.

Çfarë është dhe çfarë përfaqëson Strategjia Zhvillimore për Komunën Shtime?

Strategjia e zhvillimit të turizmit rural për Komunën e Shtimes paraqet një plan novator: për të parën herë në Komunën Shtime hartohet një Plan Strategjik i tillë duke hapur kështu rrugën për një qasje më të organizuar dhe të planifikuar drejt zhvillimit të sektorit në të ardhmen.

Një plan produkt dhe proces: kjo Strategji, si një mekanizëm institucional, mbështet synimin për rritjen e mirëqenies së banorëve të Komunës së Shtimes.

Një plan vizionar: Plani Strategjik për zhvillim të turizmit i Komunës së Shtimes i përgjigjet ndjesisë vizionare të komunitetit të tij në lidhje me zhvillimin në këtë sektor.

Një plan pragmatist: Plani Strategjik është konceptuar si një kontratë midis autoriteteve të Komunës dhe qytetarëve të saj, e cila identifikon vizionin e përbashkët, specifikon llojin, sasinë dhe cilësinë e zhvillimeve të nevojshme për përmbushjen e vizionit duke mbrojtur me çdo kusht mjedisin dhe vlerat vendore në Komunë dhe duke promovuar turizmin rural.


Një plan i përditësuar dhe realist: ky dokument duhet pajisur me materiale hartografike të cilat do të shërbejnë për të lehtësuar procesin e menaxhimit të territorit si edhe me foto - imazhe të ndryshme që

pasqyrojnë kushtet aktuale në vend dhe zhvillimin e mundshëm të turizmit rural, duke u shërbyer me përvojat e mira në region dhe me gjere.

I. PROFILI I KOMUNËS SE SHTIMES

Komuna Shtime gjendet në pjesën qendrore të Kosovës dhe përfshin qytetin e Shtimes dhe 22 fshatra me një popullsi prej 27,288 banorë¹ me rreth 4.158 familje dhe me një dendësi popullesie 203.91 banorë / km² dhe moshë mesatare 27.62 vjeç. Qyteti i Shtimes, qendra administrative e komunës ka klimë kontinentale me reshje mesatare 673 mm në vit dhe temperatura mesatare -1.4 °C në Janar dhe 20.6 °C në Korrik.

Në vendbanimet e komunës së Shtimes gjenden gjurmë të trashëgimisë historike e kulturore që prej kohës së neolitit, ilirëve, romakëve dhe vazhduar me ato të Perandorisë Osmane. Sipas defterit kadastral të vitit 1455 Shtimja i takonte Vilajetit të Vushtrrisë dhe ishte nën pushtimin osman. Në vitin 1566-74 i takonte Nahijes së Moravës me qendër në Prishtinë. Ndërsa në shekullin XIX i takonte Sanxhakut të Prizrenit. Komuna Shtime ka një sipërfaqe prej 134 km² (13.450,8 ha) dhe shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës, kufizohet me komunën e Ferizajt, Lipjanit dhe Therandës (Suharekës). Qendra administrative, qyteti i Shtimes është 31 km larg kryeqytetit të Kosovës - Prishtinës, 45 km larg Prizrenit dhe 13 km nga Ferizaj.



Pozicioni dhe ndarja e Komunës se Shtimeve sipas vendbanimeve

Qyteti i Shtimes gjendet 31 km larg aeroportit ndërkombëtar të Prishtinës, 259 km larg portit të Durrësit 220 km larg portit të Shëngjinit si dhe pozicionohet mes akseve të rëndësishme rrugore Prizren - Prishtinë dhe Prizren - Ferizaj - Shkup.

Qyteti	1	Tokë bujqësore	48,4 %
Fshatra	22	Pyje	47,4 %
Sipërfaqja	134 km ²	Rrugë urbane	15.54 km
Popullsia	27,288 banorë	Rrugë komunale	107.22 km
Nr. Familjeve	4,158	Dendësia për banorë/km ²	203.91
Popullsi urbane	7,255	Meshkuj	50,69%
Popullsi rurale	20,069	Femra	49,31%

Komuna Shtime ka nën administrimin e saj qytetin e Shtimes dhe 22 fshatra, 13 prej të cilave shtrihen në zonën kodrinore - malore dhe 9 në zonën fushore.

¹ Regjistrimi i Popullsisë i vitit 2011 - Agjencia e Statistikave të Kosovës

Komuna e Shtimes njihet si njësi territoriale - administrative që nga fillimi i shekullit XX, më saktësisht që prej Luftës së Parë Botërore. Komuna e humbet më 1932 statusin e saj për shkak të politikës shoviniste serbe të udhëhequr nga Mbretëria e atëhershme jugosllave. Pas Luftës së Dytë Botërore (1945), Shtimja ka funksionuar sërish si komunë, për ta humbur statusin përsëri në vitin 1959. Më 9 qershor të vitit 1988 është ri themeluar Komuna e Shtimes dhe sot është qendër komunale administrative e 22 fshatrave.

ZHVILLIMI EKONOMIK DHE SOCIAL

Potencialet natyrore

Komuna e Shtimes njihet për rezervat e mëdha të gurit gëlqeror, të cilat sipas matjeve të kryera në vargmalet nga Carraleva në Topillë, janë rreth 2 milionë metra kub rezerva të cilësisë së lartë, ndërkohë që ka pritshmëri dhe për rreth 9 milionë metra kub rezerva të tjera të po kësaj cilësie, duke përbërë në këtë mënyrë një mundësi shumë të madhe për ngritjen e një industrie nxjerrëse dhe përpunuese për materiale që përdoren në sektorin e ndërtimit.

Territori i komunës së Shtimes është i pasur me lumenj. Lumi i Carralevës është një ndër bukuritë natyrore të zonës, në hyrje të Shtimes bashkohet me lumin i cili buron nga malet e Topillës, për t'u bashkuar më pas në qytetin e Shtimes me lumin Shtimjanja dhe duke vazhduar nëpër fshatra me lumin Sitnica. Pellgu i lumit Shtimjanja ka një sipërfaqe prej 14 km² dhe një gjatësi afër 15 km. Përveç këtij lumi ekzistojnë edhe burime të tjera si ai në Qarrishtë, Reçak etj.

Rezervat ujore janë një resurs mjaft i mirë për zhvillimin e bujqësisë, si burim energjetik, por dhe si mundësi turizmi. Toka bujqësore përbën rreth 48,4 % të territorit të komunës dhe bujqësia është dhe mbetet një nga prioritetet zhvillimore të saj. Komuna ka rreth 6,697 ha tokë bujqësore, prej të cilave 4,947 ha janë pjellore. Kullotat zënë një sipërfaqe rreth 1750 ha, ndërsa pyjet 6377,8 ha ose rreth 47.4 % të territorit të Komunës, nga të cilat 45.9% (2926.8 ha) janë publike dhe 54.1% (3451 ha) në pronësi private duke përbërë një aks shumë të rëndësishëm për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë.

Infrastruktura

Infrastruktura² e komunës Shtime është zhvilluar në përputhje me planet urbanistike dhe strategjitë e zhvillimit, për rrjedhojë në një periudhë rreth 15 vjeçare janë investuar 39.721.464 Euro në 446 projekte, të cilat janë destinuar për shtrimin e rrugëve (150.27 km), ndërtimin e ujësjellësve (116.6 km), kanalet e ujërave të zeza (74.15 km) si dhe shtrim trotuaresh, sipërfaqe të gjelbëruara, ndriçim publik etj.. Fshatrat e Komunës janë të lidhura me rrugë të asfaltuara me qytetin e Shtimes, duke krijuar në këtë mënyrë një avantazh për zhvillimet e mëtejshme ekonomike, zhvillimin turizmit dhe zhvillimin social të komunës.

Struktura Ekonomike

Në komunë e Shtimes zhvillojnë aktivitetin 851 biznese (deri më 20.4.2015), struktura sektoriale e të cilave është si në tabelle.

² Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi

Nr.	Veprimtaria	Numri i bizneseve	%
1	Bujqësore	18	2,12
2	Financiare	5	0,59
3	Hoteliere	42	4,94
4	Industriale	7	0,82
5	Mjekësore	23	2,70
6	Ndërtimore	68	7,99
7	Prodhuese	85	9,99
8	Shërbyese	210	24,68
9	Transportuese	27	3,17
10	Tregtare	285	33,49
11	Zejtare	78	9,17
Gjithsej		851	100

Struktura e bizneseve³ në komunën e Shtimes

Klasifikimi sipas Madhësisë	Numri i punëtorëve	Numri i ndërmarrjeve	Përqindja në total
Mikro ndërmarrje	1-9	836	98,24
Të vogla	10-49	14	1,65
Të mesme	50-249	1	0,12
Të mëdha	250 e më shumë	0	0
Gjithsej		851	100,00

Klasifikimi i ndërmarrjeve në komunën e Shtimes sipas numrit të punëtorëve


Në komunë zhvillojnë aktivitetin e tyre degët e Bankës Private të Biznesit - Shtime, Raiffeissen Bank, Pro Credit Bank, BpB, KEP, Finka dhe tri institucione mikro financiare. Që nga viti 2012 funksion zyra “One Stop Shop” për regjistrimin e bizneseve e cila ka dhe një funksion tjetër, atë të këshillimit dhe informimit të bizneseve.

Zonat Ekonomike - Parku Teknologjik në Shtime

Zona Ekonomike është krijuar në përputhje me Planin Zhvillimor Komunal, ajo përfshin një sipërfaqe prej 10.7 ha, ndodhet në km e dytë të rrugës nacionale Shtime - Ferizaj dhe parashikimet janë për rreth 13 biznese dhe 350 të punësuar. Zona synon të mbështesë investitorët vendas dhe të huaj, duke u dhënë tokën në shfrytëzim, duke ngritur një pjesë të infrastrukturës si dhe duke i ofruar një numër lehtësish fiskale

Aktualisht janë duke zhvilluar aktivitetin dy agrobiznese e para merret me konservimin e perimeve (speca, tranguj etj.) e cila shumicën e produkteve e eksporton në shtetin e Austrisë, ndërsa projekti i dytë është Qendra e Agrobiznesit e cila merret me grumbullimin (blerjen), ruajtjen e frutave dhe perimeve nga Shtimja, Lipjani, Ferizaj dhe Drenasi. Tri biznese të tjera prodhuese kanë nënshkruar kontratat për vendosje në Parkun Teknologjik.

³ Drejtoria për Zhvillim Ekonomik



Bujqësia dhe blegtoria

Komuna e Shtimes e ka në traditën e saj marrjen me bujqësi⁴, veçanërisht kultivimin e grurit, misrit dhe disa kulturave të pemëve frutore, rrjedhojë kjo e sipërfaqes së madhe të tokës bujqësore dhe pjellorisë së lartë të saj, por dhe të burimeve të mëdha ujore dhe kapaciteteve njerëzore që zotëron. Vitet e fundit, bujqësia ka marrë një zhvillim të ri për shkak të kultivimit në mënyrë intensive të kulturave bujqësore, por dhe rritjes së vetëdijes së fermerëve që bujqësia është prioritet zhvillimor në komunën Shtime.

Vetëm gjatë këtyre viteve të fundit janë ngritur rreth 30 ha pemishte me mollë dhe kumbull të kultivuara në mënyrë intensive, mbi 4 ha sera për kultivimin e perimeve dhe luleve, janë ngritur 6 ferma të pulave për prodhimin e vezëve me mbi 30000 pula vojse dhe një fermë për trashjen e zogjve me kapacitet prej 3600, janë të ngritura edhe 4 ferma për prodhimin e qumështit dhe një fermë për trashjen e vëçave, rreth 20 ha me perime në sipërfaqe të hapura dhe rreth 30 ha me lakër.

Arsimi

Procesin edukativo-arsimor⁵, nga ai parashkollor deri në shkollimin e mesëm të lartë, e ndjekin 6678 nxënës, të cilët kanë në dispozicion një institucion parashkollor, shtatë shkolla fillore dhe të mesme të ulëta me 13 paralele të ndara, një gjimnaz si dhe një shkollë të mesme profesionale.

Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët është i detyrueshëm dhe përqindja e ndjekjes së shkollimit është 99.72 %, ndërsa arsimi i mesëm i lartë ende nuk është i detyrueshëm por vijueshmëria në përqindje është 94.51 %.

⁴ Sektori për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

⁵ Drejtoria për Arsim

Institucionet arsimore	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Institucioni parashkollor – çerdhja	24	15	39
Arsimi para fillor 5 - 6 vjeç	205	186	391
Arsimi fillor (1 – 5)	1128	1061	2189
Arsimi i mesëm i ulët (6 – 9)	1177	1093	2270
Gjimnazi (10 – 12)	328	447	775
Drejtimet Profesionale (10 – 12)	377	225	602
Gjithsej	3239	3027	6266

Politikat arsimore janë qendrore, ndërsa komuna luan rol të rëndësishëm në kuadër të kompetencave ligjore në mirëmbajtjen e ambienteve dhe në ofrimin e bashkëpunimit që synon rritjen e kapaciteteve dhe prioritetet e zhvillimit komunal. Sipërfaqet e mëdha të tokës bujqësore (48,4%) dhe të pyjeve (47,4%) krijojnë mundësi që nëpërmjet zhvillimit të **“kurrikulave shkollore”** jo vetëm që institucionet arsimore të ndihmojnë në zhvillimin e komunitetit arsimor natyror, por që edhe nëpërmjet aftësisë për lëmin e bujqësisë, teknologjisë së përpunimit të ushqimit dhe të veterinarisë si dhe hapjen e profilit për turizëm në Shkollën e Mesme Profesionale të ndikojnë në uljen e papunësisë rritjes së Bruto Produktit të Përgjithshëm, Indeksit të Zhvillimit Human dhe të kapitalit social.

Kultura dhe Sporti

Në komunën e Shtimes zhvillojnë aktivitetin e tyre kulturor⁶ dhe artistik disa shoqëri, ku spikat Ansambli i Këngëve dhe Valleve “Dita” nga qyteti i Shtimes. Biblioteka e Qytetit me fondin e saj të librave që pasurohet çdo ditë, i jep qytetit një dimension të ri kulturor. Gjithashtu, me qellim ruajtjen e relikteve historike dhe njohjen e së kaluarës historike të trevës së Shtimes, e cila ishte mjaft e bujshme, me plot sakrifica e luftëra për liri, më 19. 1. 2004 është themeluar Muzeu i Qytetit, për të cilin kujdeset Drejtoria për, Kulturë, Rini dhe Sport.

Historia e komunës së Shtimes lidhet me disa objekte përkujtimore si: Varrezat e Dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në Shtime dhe Mollopolc, Kompleksi Memorial “Masakra e Reçakut” si dhe një numër objektesh të kultit si kisha, xhami dhe tyrbe, varri i Ahmet Sylejmanit - Shtimja, kryetari i parë shqiptarë në Shtime. Qendra Rinore në Shtime synon masivizimin e aktiviteteve me karakter kulturor dhe social të rinjve. Komuna e Shtimes ka të themeluar Këshillin e Veprimtari Rinor Lokal të rinjve ku janë të përfshira 13 OJQ aktive. Sporti në Komunë do të marrë një dimension të ri me përfundimin e palestrës sportive, aktualisht kemi klubet sportive dhe shoqatat rekreative - sportive që janë shumë aktive.

Stadiumi i Futbollit tashmë është në funksion të klubeve të futbollit dhe sportdashësve. Shtëpia e Kulturës është duke u ndërtuar dhe pritet të përfundon në fund të vitit 2015. Është duke u restauruar Kulla e Agush Agës më saktësisht ish komuna e vjetër, ku do të vendoset Muzeu i Qytetit.

⁶ Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Shëndetësia

Kujdesi shëndetësor⁷ në komunë e Shtimes është i organizuar dhe ofrohet përmes sektorit publik shëndetësor dhe atij privat. Kujdesi Primar Shëndetësor Publik (KPSH) ofrohet përmes: Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare - QKMF “ Dr Vezir Bajrami” në Shtime dhe katër (4) Qendrave të Mjekësisë Familjare (QMF) në fshatrat: Muzeqinë, Pjetërshiticë, Petrovë dhe Godanc.

Indikatorët mjedisor

Gjendja aktuale ambientale⁸ në komunën e Shtimes lë shumë për të dëshiruar, ndotja e komponentëve kryesore ambientale siç janë uji, ajri dhe toka paraqet një kërcënim serioz jo vetëm për ambientin por edhe për shëndetin e banorëve dhe paraqet problem serioz edhe për zhvillimin e turizmit rural ne Komunën e Shtimes. Duke analizuar gjendjen e ambientit dhe shkallën e ndotjes kemi identifikuar këto problematika: *Degradimi i tokës, Ndotja e ujërave, Ndotja e ajrit. Mos menaxhimi adekuat dhe gjendja e mbeturinave:*

Legjislacioni⁹ kryesor dhe ai sekondar për fushën gjegjësisht sektorin e turizmit

- LIGJI Nr. 04/L-176 PËR URIZMIN

Ky ligj rregullon marrëdhëniet ndërmjet institucioneve publike dhe subjekteve private, personave fizik dhe juridik, vendor ose të huaj, që ushtrojnë veprimtari turistike, përcakton të drejtat dhe detyrimet e subjekteve pjesëmarrësve në fushën e turizmit në përputhje me standardet e përcaktuara më legjislacionin në fuqi.

- **Udhëzim administrativ (MTI) - nr.10/2014 për përmbajtjen e katalogut të akomodimeve**
- **Udhëzim administrativ (MTI) - nr. 19/ 2013 -Për rregullimin dhe zhvillimin e sistemit të vlerësimit të akomodimit**

- LIGJI, NR. 04/L-220 PËR INVESTIMET E HUAJA

Ky ligj ka për qëllim të rregullojë mbrojtjen, promovimin dhe inkurajimin e investimeve të huaja në Republikën e Kosovës, tu ofrojë investitorëve të huaj të drejta dhe garanci themelore, që u japin siguri investitorëve të huaj që investimet e tyre të mbrohen dhe të trajtohen në mënyrë të drejtë në pajtim me standardet dhe praktikën e pranuar ndërkombëtare.

- **Udhëzim administrativ (MTI) nr. 01/2015-për formën dhe përmbajtjen e regjistrit të investimeve të huaja**

- LIGJI NR. 04/L-159 PËR ZONAT EKONOMIKE

Ky ligj ka për qëllim themelimin e zonave ekonomike, zonave ekonomike të lira, krijimin e bazës për hartimin e planit kombëtar për zonat ekonomike, vend ndodhjen e zonave ekonomike, mënyrën e shfrytëzimit të zonave ekonomike, promovimin e zonave

⁷ Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

⁸ Drejtoria për Shërbime Publike - Sektori për ambient

⁹ <http://www.mti-ks.org/sq> - Ligjet

ekonomike, hartimin e planit kombëtar për zonat ekonomike dhe formimin e këshillit kombëtar për zonat ekonomike.

- **Udhëzim administrativ (MTI) nr. 03/2014 për procedurën, formën dhe përmbajtjen e konkursit, kushtet dhe kriteret për vendosjen e subjekteve afariste brenda hapësirave të zonave Ekonomike**

- **LIGJI Nr. 04/L-144 PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM DHE KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS**

Ky ligj ka për qëllim të rregullojë mënyrën e dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, këmbimin e pronës komunale me persona fizik dhe juridik, si dhe këmbimin e pronës me institucione qendrore dhe Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP).

- **Rregullore qrk nr. 23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës**

- **LIGJI Nr. 03/L-090 MBI PARTNERITETET PUBLIKO PRIVATE DHE KONCESIONET NË NFRASTRUKTURË DHE PROCEDURAT PËR DHËNIEN E TYRE**

Ky ligj ka për qëllim të caktoj kornizën ligjore për dhënien e Partneritetit Publik Privat dhe koncesioneve për të ndërtuar, shfrytëzuar, dhe/ose eksploatuar infrastrukturën publike dhe për të ofruar shërbime publike.

LIGJI NR. 04/L-045 PËR PARTNERITET PUBLIKO PRIVAT

Ky ligj ka për qëllim krijimin e kornizës ligjore për partneritet publiko privat duke përfshirë procedurat për të hyrë në një partneritet publiko privat, përmbajtjen dhe strukturën marrëveshjeve për Partneritet Publiko Privat si dhe strukturën institucionale përgjegjëse për menaxhimin dhe zhvillimin e Partneritetit Publiko Privat në Republikën e Kosovës.

DIREKTIVA Nr. 4/2012 për Publikime të Njoftimeve PPP

DIREKTIVË Nr. 1/2011 Mbi procedurat për shqyrtimin dhe aprovimin e projekteve PPP

DIREKTIVË NR. 2 / 2011 Për Ekipet për Menaxhimin e Projekteve

DIREKTIVË NR. 3 / 2011 Për Shqyrtimin dhe miratimin e projekteve komunale PPP

Ne aspektin institucional ne nivel nacional trajtimi si industri mbulohet nga Divizioni i Turizmit i cili funksionon në kuadër të Departamentit të Industrisë, kurse ne nivel komunal, komuna e Shtimes turizmin e trajton përmes Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik.

METODOLOGJIA E PERDORUR

Komuna e Shtime bazuar në dëshirën për zhvillimin e hovshëm komunal ka treguar interesim dhe motivim për hartimin e strategjisë për zhvillim të turizmit rural për periudhën afatmesme 2015 - 2019. Me një mbështetje të plotë të kryetarit të komunës dhe me ndihmën e madhe të ekspertëve të Komunës nga departamentet përkatëse të administratës komunale janë krijuar kushtet e nevojshme teknike dhe njerëzore për zhvillimin e këtij projekti shumë të rëndësishëm për komunën e Shtimes.

Në fazën e Parë, eksperti i angazhuar nga CDF Dr.Ibrahim Krasniqi ka performuar aktivitet në vijim gjatë implementimit të projektit i cili është duke u avancuar dhe synohet që në nëntor të shkoj drejt fazës përfundimtare. Në fillim është organizuar:

- Takimi me Kryetarin dhe koordinatorët e projektit si dhe përfaqësuesit e komunës
- Takim për krijimin e grupit punues në Komunën e Shtimes
- Punëtori me grupin punues komunal dhe palët e interesit dhe prezantimi i draftit fillestar për strategjinë e zhvillimit të turizmit rural në Komunën e Shtimes.

Themelimi i Ekipit dhe Grupit Punues për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit Rural të Komunës së Shtimes 2015 - 2019

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-40 Neni 58, Kryetari i Komunës ka nxjerr,

VENDIM

Për formimin e ekipit për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit të Turizmit Rural të Komunës së Shtimes 2015-2019 në përbërje:

- Sabri Çerkini, (udhëheqës ekipi), drejtor për Zhvillim Ekonomik
- Mehdi Salihu, drejtor për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi
- Ekrem Reçica, drejtor për Administratë të Përgjithshme
- Ardiana Rama, drejtoreshë për Shërbime Publike
- Hajrullah Ademaj, drejtor për Arsim
- Fatmire Ferati, drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport
- Musë Baftiu, drejtor për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
- Kimete Ukaj, Zyrtar Kryesor Financiar
- Safet Brahimi, Zyrtar për Zhvillim Ekonomik
- Lulzim Sahiti, Përgjegjës për Informim dhe marrëdhënie me publikun
- Ejup Ismajli, Koordinator i Sektorit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural & Kryetar i GLV "Natyra" - Shtime
- Bashkim Ahmeti, Përgjegjës për Bujqësi
- Shqipe Rexhaj, Përgjegjës për Urbanizëm
- Fatmir Rexhepi, Përgjegjës i sektorit - Zyrtar për Ndërtim
- Albulena Emimi, Zyrtar për mjedis
- Muhadin Halili, Menaxher i zyrës së prokurimit
- Hava Qarri, Zyrtar i prokurimit
- Feride Rexhaj, Zyrtar për financa në drejtorinë e Arsimit
- Rexhep Limani, kryetar i "Klubit të Biznesit" - Shtime
- Adriatik Beqa, anëtar i "Klubit të Biznesit" - Shtime
- Shqiponjë Maksutaj, anëtar i GLV "Natyra" - Shtime
- Jaseminë Hysaj, koordinatorë e projektit në Balkan Sunflowers

Takimi me koordinatorët e projektit dhe përfaqësuesit e komunës - Takimi i parë pas përgatitjeve dhe diskutimeve paraprake është realizuar më datën 10.7.2015 në të cilin është diskutuar rreth strategjisë së turizmit rural dhe zhvillimit të mëtejshëm të projektit.



Takim pune me grupin punues dhe përgjegjësit komunal

Këtu është sugjeruar metodologjia dhe mënyra e realizimit të suksesshëm të projektit për përfundimin e strategjisë. Më pas është vazhduar me takime të radhës dhe punëtori brenda dhe jashtë Komunës në lidhje me projektin e hartimit të strategjisë. Takimet janë organizuar në formë të punëtorive në të cilat është diskutuar strategjia si nevojë e domosdoshme dhe në të cilën janë dhënë rekomandime dhe analiza profesionale në lidhje me strategjinë.



Në kuadër të vizitës studimore Parkut Nacional të Valbonës dhe Thethit Grupi Punues diskutoi dhe mori në konsideratë praktikën e mira të përdorura nga organet lokale dhe komuniteti për sektorin e turizmit rural dhe atij malor. Në këtë kuadër u vizituan edhe monumente të trashëgimisë dhe u diskutua për valorizimin e këtyre vlerave edhe në Komunën e Shtimes.

Në muajt korrik dhe gusht është organizuar punëtori me grupin e ekspertëve dhe me palët e interesit për të diskutuar rreth:

- Identifikimit të problemeve aktuale
- Analizës profesionale të problemeve të identifikuara
- Rekomandimet e ekspertëve për problemet e identifikuara
- Rekomandimet për aspektin zhvillimor në fushën e turizmit rural.

Punëtorja u fokusua kryesisht në faktorët e rëndësishëm që mund të ndikojnë në implementimin e strategjisë dhe në të gjitha palët e interesit në elementet në vijim:

- Problemet/nevojat/ kërkesat - Ishikava diagrami
- Palët e interesit, interesat e tyre
- Misioni, Vizioni, Qëllimet, Objektivat, Prioritetet
- Iniciativa
- Risku
- Pikat kyçe
- Projekt propozimet eventuale

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KOMUNËS SË SHTIMES

Kuvendi i Komunës së Shtimes funksionon në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040), Statutit dhe akteve të tjera nënligjore. Komunitat i ushtrorjnë kompetencat e tyre sipas parimit të subsidiaritetit:


- kompetencat vetanake,
- kompetencat e deleguara dhe
- kompetencat e zgjeruara, në përputhje me ligjin.

Komunitat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm. Kuvendi i Komunës së Shtimes është organi më i lartë në Komunë i cili zgjedhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet lokale. Kuvendi ka 21 delegatë dhe Komitetet, të cilat konsiderohen si të nevojshme për kryerjen e përgjegjësve të tyre:

Komitetet obligative janë:	Komitetet jo obligative janë:	Komitetet konsultative janë:
<i>Komiteti për Politikë e Financa</i> <i>Komiteti për Komunitete</i>	<i>Komiteti i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale</i> <i>Komiteti për Arsim</i> <i>Komiteti i Zhvillimit Ekonomik</i> <i>Komiteti për Urbanizëm, Pronë, Gjeodezi, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit</i>	<i>Komiteti për Barazi Gjinore</i> <i>Komiteti për Persona me Aftësi të Kufizuara</i> <i>Komiteti i Kategorive të Dala nga Lufta.</i>

ORGANIGRAMI I KOMUNES SE SHTIMES

Ekzekutivi - Administrata¹⁰ e komunës organizohet në drejtori, si në vijim:



KOMUNITETI DHE DINAMIKA E ZHVILLIMIT TE TURIZMIT RURAL NE KOMUNEN E SHTIMES

1. Përkufizimi i turizmit rural

Sot turizmi paraqet tregues i zhvillimit të civilizimit tonë, për disa njerëz është mënyrë e rritjes së nivelit të kulturës, argëtim apo shërim, për disa mundësi për përfitim, por duhet të shënohet se turizmi është një nga tregimet e jashtëzakonshme për suksesin në kohën e sotme. Industria, e cila filloi zhvillimin e saj në vitet e 50 - ta të shekullit të kaluar, rritet shumë shpejt dhe sigurisht në 60 vitet e kaluara në krahasim me të hyrat që i gjeneron dhe numrin e njerëzve që udhëtojnë jashtë vendit. Sipas të dhënave të Organizatës Botërore të Turizmit, më shumë se 935 milionë njerëz kanë udhëtuar në nivel ndërkombëtar në vitin 2010 në krahasim me 25 milionë njerëz në vitin 1950. Potenciali për rritjen e turizmit mund të ndërlihet si strategji për turizmin rural.

Hapësira rurale të cilën e përbëjnë hapësira jashtë qytetit, vazhdimisht transformohet. Numri i banorëve që jetojnë në këtë hapësirë vazhdimisht bie, numri i atyre që merren me bujqësi është i vogël, ndërsa dallimet rajonale në zhvillim gjithnjë e më shumë janë të theksuara.

Mjedisi rural përfshin hapësirën natyrore gjeografike në të cilin dominojnë veprimtaritë primare (bujqësia, pylltaria, peshkataria dhe blegtoria), zakonisht infrastruktura e zhvilluar dobët ekonomike dhe institucionale.

Në shtetet e ndryshme, përcaktimi i llojit të rajoneve rurale bëhet në mënyrë të ndryshme. Për shembull në Angli dhe Vels, si rajon rural konsiderohet ai ku banorët jetojnë në lagje që ka më pak

¹⁰ Zyra e Personelit

se 10.000 banorë, në Austri ku ka 5.000 banorë, në Australi dhe Kanada 1000 banorë e kështu me radhë.

Foiera e trajton turizmin rural si tërësi e të gjitha llojeve dhe formave të turizmit, të praktikuara në mjedisin rural. Vëmendja përqendrohet në kontrastin midis mjedisit rural dhe të qytetit. Sipas autorit turizmi rural është lloji themelor i turizmit, i cili përfshin në vete të gjitha format e turizmit të praktikuar në mjedisin rural. Foiera nuk parasheh ofertën e detyrueshme turistike për të kyçur kryerjen e punëve afariste të fshatit. Kriteri është jo ai i cili zhvillon turizmin rural, por ku zhvillohet turizmi d.m.th. kushti është të jetë në mjedisin rural. Vendosja e turistëve bëhet jo vetëm në shtëpitë e nikoqirit të fshatit, por edhe në hotele, motele, kampe dhe pushimore në afërsi të nikoqirit. Karakteristikat dhe veçantitë mes turizmit urban dhe atij rural përfshin:

Në tabelën nr 1 është treguar krahasimi midis turizmit urban dhe rural. Burimi: Lane, B., "What is rural tourism?", Journal of sustainable tourism, V. 2, I. 1&2, p.7-21, 1994

Turizmi urban	Turizmi rural
Pak hapësirë e hapur	Hapësirë e mjaftueshme
Vendbanime mbi 10000 banorë	Vendbanime nën 10000 banorë
Banim i dendur	Banim i rrallë
Mjedis i ndërtuar	Mjedis natyror
Shumë aktivitete në hapësirë të mbyllur	Shumë aktivitete në hapësirë të hapur
Infrastruktura intensive	Infrastruktura e dobët
Argëtim i lartë	Bazë e fortë individuale për aktivitet
Ndërmarrje të mëdha	Ndërmarrje të mesme dhe të vogla
Pronësia nacionale/ndërkombëtare e bizneseve	Biznese në pronësi lokale
Nuk përfshihen të shumtën aktivitetet fermerësh	Aktivitetet fermerësh etj
Turizmi vetëm për interesat vetanake	Turizmi përkrah edhe interesat e tjerëve
Të punësuarit larg nga puna	Të punësuarit lokal dhe shpesh jetojnë afër punës
Rrallë nën ndikimin e faktorëve sezonal	Shpesh varet faktori sezonal
Shumë mysafirë	Numër modest i mysafirëve
Raportet anonime me mysafirë	Raportet personale me mysafirë
Menaxhim profesional	Menaxhim amator
Atmosferë kozmopolite	Atmosferë lokale, raritete
Ndërtesa shumë moderne	Ndërtesa klasike, bujtina, hane
Zhvillim dhe etikë për rritje	Etikë konservatore/rritje e kufizuar
Pamje të zymtë dhe të ngjashme	Pamje të veçanta dhe speciale
Marketing i gjerë	Marketing i kufizuar

Faktorët themelor të cilët mundësojnë ekzistimin e turizmit rural mund të formulohen në këtë mënyrë:

- Ekzistimi i vlerave natyrore dhe antropogjenë turistike;
- Objektet bashkëkohore për vendosje;
- Faktori njerëzor;

- Përkrahja institucionale;
- Infrastruktura e ndërtuar sociale dhe prodhuese;
- Ekzistimi i kërkesës së vazhdueshme turistike, sigurimi i kërkesës së vazhdueshme të prodhimit rural turistik dhe shfrytëzimi efektiv i kapaciteteve për vendosje dhe
- Rendi dhe ligjshmëria në mjediset rurale.

Autorë të ndryshëm bëjnë ndarjen e objekteve për vendosje në turizmin rural në:

- Shtëpi rurale me arkitekturë tradicionale;
- Apartamente dhe dhoma në shtëpi me arkitekturë bashkëkohore;
- Amvisëri bujqësore me EKO ofertë dhe
- Hotele të vogla familjare rurale.

Në Japoni p.sh. hotelet të cilat merren me turizëm rural mund të ndahen në katër grupe: grupi i parë është i financuar dhe i udhëhequr nga shteti, grupi i dytë është i financuar dhe i udhëhequr nga sektori privat, i treti është i financuar nga shteti por i udhëhequr nga banorët lokal dhe grupi i katërt janë hotele të financuara dhe të udhëhequr bashkërisht nga shteti dhe banorët lokal (partneriteti privat publik).

Në Evropën Perëndimore shënohet një tendencë e re në zhvillimin e turizmit rural, e cila është e pranishme edhe te ne. E lidhur me luksin e turizmit masovik dhe thjeshtësia e mjedisit rural. Për këtë qëllim pajisja e dhomave është përpunuar nga druri, guri, si dhe janë të aranzhuara shumë lule. Janë futur elemente të reja natyrore, uji në formë të ujëvarës dhe basene për notim.

PROFILI TURISTIK I KOMUNËS SË SHTIMES

Në territorin e komunës së Shtimes nuk ka ndonjë objekt apo zonë turistike me infrastrukturë përcjellëse ku qytetarët e Shtimes do të mund të kalonin pushimet dhe vikendet. Me fjalë të tjera në Shtime aktualisht nuk ka ofertë turistike, por qytetarët Shtimjan ofrojnë ne pjese te caktuara te territorit te Shtimes oferta individuale dhe po ashtu bëjnë turizëm në zonat e tjera turistike, si Blinaja(gjueti), Brezovicë (skijim, etj), Prevala (shëndetësorë) dhe qendrat apo zonat e tjera që ndodhen në Kosovë.

Objektet që ofrojnë qëndrim dhe akomodim 24 orë kanë në dispozicion 70 dhoma me numër të shtretërve 80. Numri i vizitorëve për një muaj është 350. Ne këto objekte përfshihen motele , restaurantet dhe pishinat:

- o Motel ‘‘TIRANA’’ në fshatin Carralevë
- o Restaurant ‘‘TITANIC’’ & Motel në fshatin Davidovc
- o Restaurant ‘‘TROFTA’’ në fshatin Petrovë
- o Motel ‘‘GRANITI’’ & Pishina në fshatin Belinc
- o Restorant ‘‘GLOBUS’’ në kilometrin e tretë të magjistrales Shtime - Ferizaj
- o Restaurant ‘‘VILLA PLUS’’ & Motel në fshatin Dugë
- o Motel ‘‘MENTORI AG’’ në fshatin Davidovc
- o Motel & Restaurant ‘‘RELAX’’ në fshatin Davidovc
- o Motel ‘‘VILLA ART’’ Në Rrugën ‘‘Komandant Kumanova’’ - Shtime
- o Restaurant ‘‘KRONI’’ & Motel në fshatin Pjetërshticë
- o Restaurant ‘‘AQU-PARK’’ & Pishina në fshatin Davidovc
- o Restaurant ‘‘LIDO’’ & Pishinë në fshatin Davidovc
- o Pishina ‘‘CREJZI’’ në Lagjen e Pajtimit



Restaurant & motel "Villa Plus" në fshatin Dugë



Restaurant "Trofta" në fshatin Petrovë

▶ Atraksionet turistike natyrore



Pamje atraktive nga "Gryka e Llanishtit"

- Në mesin që ndan fshatrat Carralevë dhe Belinc rritet një lloj i veçantë i lules i cili quhet: "Lule Bozhur", po ashtu në këto dy fshatra rritet dhe kultivohet "Çaji i Malit"
- Është në rrugë e sipër projekti për rregullimin e hapësirave publike, përkatësisht Parku te Qendra Rinore në Shtime. Ky projekt financohet me 48,000€ nga Qeveria Zvicerane, i cili do të zbatohet nga Helvetas Swiss Intercooperation e Fondacioni Zviceran për Zhvillim dhe Bashkëpunim, kurse Komuna e Shtimes do të participon me 30%.

▶ Parqet, shëtitore dhe zona rekreative





Zonë e rekreative në qytetin e Shtimes me sipërfaqe prej 15ha dhe sheshet ne qytetin e Shtimes

III. SFIDAT E IDENTIFIKUARA ZHVILLIMORE NE SEKTORIN E TURIZMINT RURAL

- Zhvillimi i paplanifikuar në sektor dhe shkalla e lartë e papunësisë - fatkeqësisht nuk ka ekzistuar një planifikim i mirëfilltë strategjik për këtë sektor.
- Resurset turistike natyrore nuk janë trajtuar në mënyrë të duhur dhe ka vend për përmirësim në valorizimin dhe ruajtjen e tyre (mungesa e regjistrimit turistik, prerja e pakontrolluar e pyjeve).
- Gjatë planifikimit duhet të kemi parasysh shfrytëzimin e këtyre vlerave dhe mbrojtjen e tyre për brezat e ardhshëm.
- Shfrytëzimi joracional i resurseve turistike rurale, kulturore, mjedisore, të hapësirës etj.
- Mjedisi pa fajin e Komunës paraqet një problem nacional i cili është reflektuar edhe këtu prandaj duhet trajtuar këtë sfidë të ketë hapa konkret drejt përmirësimit të mjedisit.
- Infrastruktura jo e mjaftueshme teknike - Përkundër investimeve të mëdha që janë bërë nga komuna bashkë me donatorë tjerë konsiderojmë që për ta pasur një infrastrukturë të mirë që i plotëson nevojat e zhvillimit të turizmit, e sidomos atij malorë duhet investime shtesë në asfaltimin e rrugëve të reja dhe hapjen e shtigjeve për këmbësorë që dërgojnë deri tek vendet turistike, vendet e trashëgimisë natyrore dhe trashëgimisë historike
- Niveli i shërbimeve shëndetësore dhe sociale - edhe pse ka shumë hapa të ndërmarrë nga Komuna, prapë ngelet një sfidë e madhe që vjen si rezultat i papunësisë, mungesës së sigurimeve shëndetësore etj.
- Arsimimi - Komuna ka bërë shumë në këtë drejtim por mbetet sfidë cilësia dhe përgatitja për treg pune.

Trashëgimia kulturore¹¹ dhe benefitet ekonomike prej saj - turizmi kulturor dhe historik

Që nga koha e bronzit dhe hekurit, Shtimja ishte e banuar nga popullsia ilire e fisit të dardanëve, të shpërndarë në kala të shumta dhe vendbanime kodrinore e fushore. Në kohën e sundimit të Perandorisë Romake u zhvillua rrjeti i vendbanimeve urbane dhe i rrugëve, të cilat lidheshin me sistemin rrugor të Perandorisë. Në Kosovë rrjeti i



vendbanimeve, gjatë kësaj kohe, dendësua dukshëm. Numri i kalave iliro-dardane si ajo mbi fshatin Petrovë (e cila ka shenja të mbuluara nga dushqet dhe myshqet të cilat në të ardhmen duhet të hulumtohen për t'u zbardhur historiku i tyre. Pas shkatërrimit të shumë kalave iliro-dardane antike (prej luftërave dhe tërmetit të fortë të vitit 518) u zhvillua sistemi i vendbanimeve në kohën bizantine (shek. IV-XII). Vlen të përmendet Kështjella mesjetare e Topillës, e cila gjendet në një ngushticë 10 km në jug të Shtimes, e cila shtrihet



Shtimja e viteve të '50-ta

nëpër luginën e Topillës. Kështjella në fjalë, gjendet mbi një shkëmb në të djathtë matanë rrugës dhe populli e quan "Guri i Shtrenjtë". Asokohe kjo kështjellë siguronte rrugën dhe shërbente për mbrojtjen e pjesës perëndimore të Fushës së Kosovës dhe të qytetit të Shtimes. Gjatë viteve 1998 - 1999, në këtë komunë u organizua Ushtria Çlirimtare e Kosovës, përkatësisht Zona Operative e Nerodimes, me seli në fshatin Mollopolc, si dhe një pjesë e Zonës Operative të Pashtrikut. Në ditët e sotme në këtë grykë shërbehet me ushqime tradicionale, andaj është një potencial për zhvillimin e turizmit rural në këtë pjesë duke e shfrytëzuar edhe si vend për vizitorë nga aspekti i peshës historike. **Përveç objekteve të paraqitura më lartë (Shtimja e viteve 50-ta dhe Mbeturinat e Kështjellës Mesjetare "Guri i Shtrenjtë" pranë Shtimes), në komunën e Shtimes ekzistojnë edhe shumë objekte tjera të rëndësishme të cilat mund të luajnë rol në turizmin kulturor dhe rural përfshirë objektet si:**

- *Kalaja e Petrovës - Lugu u Gjytetit*
- *Kulla E Agush Agës,*
- *Tyrbja E Shtimes,*
- *Vendlindja e Ahmet Shtimes,*
- *Xhamia e Vjetër e Shtimes,*
- *Xhamia e Rashincës,*

¹¹ Plani Zhvillimor Komunal për objektet e trashëgimisë kulturore, fetare dhe natyrore - Lulzim Sahiti

- *Xhamia e Carralevës,*
- *Kulla e Muhamet Begut*
- *Kulla e Sherif Agës në Vojnovc,*
- *Kulla e Ramë Sylës së Vojnovcit,*
- *Kulla e Sahitit në Carralevë .*
- *Shkolla e Parë në Shtime,*
- *Shtëpia e Përshpirtshme*
- *Objekti i Shkollës Filllore në Muzeqinë,*
- *Kisha Ortodokse e Mihail Arkangjelit të Shenjtë,*
- *Shpella e Pjetërshticës,*
- *Shpella e Imer Devetakut - Devetakë,*
- *Vrella e Zezë - Gryka e Llanishtit,*
- *Trungjet e dushkut në: Mollopolc, Godanc i Ulët, Godanc i Epërm, Rashincë, Karaçicë dhe Gështenjat në Shtime,*
- *Kompleksi Përkujtimor “Masakra E Reçakut” - Reçak,*
- *Sheshi i UÇ K - së me Monument Artistik*
- *Varrezat e Dëshmorëve në Shtime*
- *Varrezat e Dëshmorëve në Mollopolc*



Pllakë përkujtimore kushtuar Ahmet Shtimes dhe Rexhep Muratit në grykë të Topillës



Shkolla e vjetër (Shtëpia e Përshpirtshme)



Objekti i komunës së vjetër



Kompleksi Përkujtimor “Masakra e Reçakut”



Kulla e Sahitit e ndërtuar në shekullin e 19-të

Toka dhe mundësia e shfrytëzimit për turizëm rural

Për nga peizazhi gjeografik¹², si vlera të përgjithshme turistike në territorin e komunës së Shtimes ka dy lloje të peizazheve, fushën e cila shtrihet kryesisht në pjesën lindore dhe malet të cilat shtrihen në pjesën perëndimore të komunës së Shtimes. Ka mundësi të mira të zhvillimit të turizmit kulturorë dhe rural-malor.


Vlerat më të mëdha turistike kryesisht shtrihen në pjesën perëndimore të komunës, në vendbanimet si Reçak, Petrovë, Mollopolc, Rancë, Belinc, Topillë, Caralevë, Dugë, Zborc dhe Pjetërshticë. Në këto vendbanime është e koncentruar gati e gjithë trashëgimia kulturore dhe natyrore e karakterizuar me dendësi të vogël banimi, me frekuentim të vogël, ndotje të vogël, shkallë të madhe të degradimit të mjedisit nga gurthyesit, me klimë të përshtatshme, etj.

Shpërndarja e aktiviteteve hoteliere në komunën e Shtimes

Elemente tjera turistike të kësaj zonë janë: Kompleksi Memorial i Reçakut, Shpella e Pjetërshticës (nuk ka infrastrukturë) etj. Ndërsa, zona lindore e lequar me peizazh fushor, është kryesisht zonë

¹² Plani Zhvillimor Komunal 2009 - 2020 për komunën e Shtimes

agrarë, me dendësi të madhe banimi, ndotje më të madhe etj, dhe mu në këtë zonë ndodhën numri më i madh i moteleve dhe pishinave, të cilat shtrihen kryesisht përgjatë akseve rrugore të rëndësishme nacionale, kurse, pjesëmarrja e bizneseve hoteliere ndaj numrit të përgjithshëm të bizneseve është 4.94%, me strukturë kryesisht hoteleri dhe të koncentruar kryesisht në vendbanimet si Shtime, Rashincë, Carralëvë, Pjetërshiticë, Godanc i Ulët dhe i Epërm dhe Petrovë.



Problemet dhe sfidat e identifikuara zhvillimore

II. - SWOT Analiza e sektorit të turizmit rural në Komunën e Shtimes

	Përparësitë	Dobësitë
MJEDISI I BRENDSHEM	<ul style="list-style-type: none"> ○ Pozitë e volitshme gjeografike. ○ Distanca e shkurtër rrugore nga kryeqendra e Kosovës, Prishtina ○ Resurse natyrore ○ Pasuri natyrore dhe biodiversitet i pasur ○ Vlerat historike e kulturore ○ Peizazhe piktoreske , ○ Ekzistenca e pasurive të ndryshme natyrore që lejojnë zhvillimin e disa llojeve të turizmit, ngjytjeve malore etj. ○ Tradita të forta të artit popullor ○ Tradita të forta bujarie dhe mikpritjeje ○ Akses i afërt në rrjetin rrugor kombëtar nëpërmjet aksit Prishtine - Durrës dhe Prishtinë - Shkup ○ Pjesëmarrje në iniciativa e programe të bashkëpunimit regional ○ Infrastrukturë e kënaqshme e rregulluar, ○ Ekzistenca e planeve zhvillimore afatgjate, ○ Emërtimi i rrugëve në vendbanime 	<ul style="list-style-type: none"> ○ Ndotja mjedisore - e ajrit, ujit dhe dheut nga fabrikat, trafiku, mbeturinat dhe uji i ndotur si pasojë e menaxhimit joadekuat ○ Kapacitete të limituara akomoduese dhe cilësi jo e lartë shërbimi ○ Bashkëpunim i dobët mes autoriteteve publike dhe industrisë së turizmit ○ Mungesë "Inovacioni" dhe paketash të integruara që lidhin turizmin malor dhe të tjera ○ Rregullim i dobët Urban dhe ndotje Urbane ○ Mungesa e shërbimit shëndetësor të shpejtë nëpër zona malore ○ Fondet e vogla në mirëmbajtjen e infrastrukturës

Mundësitë	Rreziqet
<ul style="list-style-type: none"> ○ Turizmi rural - zhvillimi i produkteve lokale, ○ Themelimi zyrës për zhvillim të turizmit ○ Përmirësimi i infrastrukturës ○ Zhvillim i mëtejshëm i sektorit të bujqësisë ○ Rritja e prodhimeve BIO dhe prodhimeve të certifikuara ○ Kërkesë në rritje nga tregu vendas për turizmin dimëror dhe të natyrës ○ Mundësi për zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit (përfshi lloje të reja të turizmit si ai aventurier, kulturor, natyror etj.) ○ Rritja dhe përmirësimi i kapaciteteve akomoduese dhe të shërbimeve turistike. ○ Rritja e promovimit të turizmit të Komunës brenda dhe jashtë vendit ○ Treg i hapur drejt sipërmarrjeve të reja turistike (welcoming market) ○ Politika për tërheqjen e investitorëve ○ Potenciale për Iniciativa për zhvillimin e bizneseve turistike dhe sidomos sportive dimërore. ○ Mjedis pa ndotje industriale ○ Rimëkëmbja e prodhimeve artizanale ○ Promovim i kuzhinës vendase bazuar në shfrytëzimin e produkteve BIO të zonës ○ Fondet strukturore të BE - së, Partneriteti 	<ul style="list-style-type: none"> ○ Mungesa e zbatimit strikt të infrastrukturës ligjore ○ Sistem jo i integruar siç duhet me tregun turistik kombëtar dhe ndërkombëtar ○ Motivim financiar jo i mjaftueshëm për zhvillimin e turizmit rural ○ Konkurrencë nga zona të tjera të afërta rurale - malore me turizëm më të zhvilluar ○ Menaxhim jo i qëndrueshëm i mbetjeve urbane dhe pasurive natyrore ○ Zhvillim i vonuar i turizmit të qëndrueshëm ○ Globalizimi (zbehja e traditave kulturore) ○ Furnizim jo stabil me energji elektrike, ○ Mos eliminimi i ndotësve si furrat gëlqerore, gurthyesit ○ Konkurrenca regjionale

DEKLARATA E VIZIONIT DHE MISIONIT

VIZIONI

“Komuna e Shtimes krijon mundësi dhe potenciale për zhvillimin e turizmit rural, shfrytëzimin e burimeve natyrore duke ruajtur mjedisin, trashëgimin natyrore, kulturore dhe historike”.

MISIONI:

“Zgjerimi, mbështetja dhe rritja e ofertës turistike në zonat rurale të Komunës së Shtimes me qellim të përmbushjes së vizionit të mësipërm dhe shndërrimit në një sektor kontribuues për të mirën e komunitetit dhe Komunës”

QËLLIMET E ZHVILLIMIT TË SEKTORIT TURISTIK PËR SHTIME

Qëndrueshmëria dhe turizmi i qëndrueshëm rural

Koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm u shfaq në vitet 80 - ta të shekullit të 20, kur shoqëritë u bënë gjithnjë e më të vetëdijshëm për ndikimin e pakthyeshme të zhvillimit të shpejtë ekonomik në burimet natyrore dhe në mjedis në përgjithësi. Kjo është një temë e nxehtë sot, që nuk nënkupton përsheptimin e ekonomisë kombëtare, duhet të bëhet në llogarinë e përdorimit të papërgjegjshëm të burimeve turistike dhe tjera natyrore dhe duke injoruar vlerat natyrore dhe kulturore. Prandaj në aspektin afatmesëm qëllimet e zhvillimit të sektorit të turizmit rural në Komunën e Shtimes mund të kategorizohen në:

E tërë kjo bazohet në 10 Parimet themelore të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit nga Organizata Botërore e Turizmit:

- 1. Konservimi dhe parandalimi i shterimit të burimeve natyrore, sociale dhe kulturore*
- 2. Reduktimi i mbi - konsumit dhe mbetjeve*
- 3. Mirëmbajtja dhe përmirësimi i diversitetit natyror, social dhe kulturor*
- 4. Integrimi i zhvillimit të turizmit në planifikimin e strategjisë lokale dhe kombëtare, vlerësimi i ndikimit në mjedis*
- 5. Mbështetja e aktiviteteve lokale ekonomike dhe vlerësimin e kostove të Mbrojtjes së Mjedisit*
- 6. Përfshirja e popullatës lokale në sektorin e turizmit*
- 7. Shkëmbim konsultimi midis industrisë së turizmit dhe popullatës lokale, organizatave dhe institucioneve*
- 8. Trajnimi i rregullt i stafit të shërbimit dhe emërimin e vendasve në të gjitha pozicionet e kompanisë turistike*
- 9. Vlerësimi i përgjegjësisë së tregut të udhëtimit, duke siguruar një informacion të plotë për turistët*
- 10. Hulumtim i vazhdueshëm dhe monitorimi i industrisë së turizmit*

Ekoturizmi, turizmi rural, turizmi natyral, turizmi i gjelbër dhe turizmi arsimorë mund të konsiderohen të gjithë si sektorë të turizmit që lehtësojnë zhvillimin e qëndrueshëm.

Burimet e turizmit rural dhe infrastruktura

Çelësi i zhvillimit të turizmit rural është popullata vendase që përdorin burimet natyrore dhe vlerat kulturore dhe historike të bëra nga njeriu dhe infrastruktura përkatëse për të krijuar produkte të turizmit dhe që pastaj ti ofrojnë ato shërbime dhe produkte për turistët. Natyra dhe mjedisi rural janë parakushti kryesor për zhvillimin e turizmit rural. Burimet më të rëndësishme janë peizazhet të ndryshme dhe diversiteti biologjik, ujërat (lumenj, liqene, burimet, ligatinat), pyjet, livadhet, kënetat, zonat e mbrojtura natyrore - rezervat e biosferës, parqet kombëtare, parqe natyrore, të mbrojtura, rezervat e natyrës, si dhe lloje të veçanta të kafshëve të egra.

Në vitet e fundit turistët janë tërhequr gjithnjë e më shumë nga jeta rurale - dyqane artizanale dhe ferma ku ata mund të marrin pjesë në punë. Ngjarjet popullore - tregjet rajonale, ditët e zanateve, festimet e festave vjetore, traditave dhe zakoneve, si dhe jetën e përditshme të fermave rurale, të cilat hapin dyert e tyre për vizitorët. Për këtë arsye zhvillimi i infrastrukturës lehtëson zhvillimin e mjedisit rural, duke siguruar përputhjen me kërkesat e mbrojtjes së mjedisit. Për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat për mbrojtjen e mjedisit dhe për të mundësuar turistëve për të hyrë në

bukuritë natyrore, infrastruktura e veçantë duhet ndërtuar në zonat e mbrojtura të natyrës si shtigje, urave të vogla, shkallët, mbrojtjen dhe barrierat, spote - pika të relaksimit, zonat e vëzhgimit, kullat për shikimin, etj.

Ndikimi mjedisor i turizmit rural

Turizmi rural është bërë një nga llojet më të popullarizuara të turizmit gjatë viteve të fundit kudo. Megjithatë për Shtimin mbesin shumë sfida të adresohen në këtë dokument strategjik. Çështja e konsumit të ujit dhe kontrollit të tij, e ujërave të zeza, e mbetjeve dhe shumë çështje tjera janë problem që duhet të adresohen në mënyrë imediate.

Pothuajse të gjitha pikat rurale të turizmit regjistrojnë konsumin e përgjithshëm të energjisë elektrike, edhe konsumin e energjisë për mysafir. Ende forma alternative e prodhimit të energjisë praktikisht nuk janë duke u përdorur. Turizmi rural lë një ndikim pozitiv në mjedis ekonomik dhe zhvillimin e zonave rurale dhe qytetet e vogla si në Shtime - ndikon në normat në rritje të punësimit, duke rritur larminë e biznesit dhe aktivitetin, duke përmirësuar shitjet e mallrave dhe shërbimeve, mbledhjen e taksave, renovimin dhe mirëmbajtjen e kulturës dhe trashëgimisë historike, popullata lokale krenohet dhe kujdeset me vlera natyrore dhe historike të rajonit, dhe kështu nivelet e zhvillimit ndërmjet rajoneve do të fillojnë për t'u barazuar.

Drejtimit strategjike

Në ndjekje të vizionit të Shtimes për zhvillim e turizmit rural, qëllimeve dhe në bazë të parimeve të mësipërme, drejtimit strategjike për zhvillim e turizmit rural viteve të ardhshme duhet të jenë të thjeshta dhe të matshme..

Çdo drejtim strategjik ka një seri objektivash kyçe dhe veprimeve të lidhura të destinuara për të çuar përpara përpjekjet e Komunës drejt arritjes së vizionit të përgjithshëm të Strategjisë. Këto objektiva dhe veprimet janë krijuar bazuar në një kombinim faktorësh duke përfshirë drejtimin strategjik të Komunës, përparimit të projekteve të nevojshme për të mundësuar zbatimin efektiv të veprimeve kyçe dhe disponueshmërinë e burimeve. Këto drejtime strategjike përfshijnë:

Drejtimi strategjik 1	Politike të qarta zhvillimore të turizmit rural
Drejtimi strategjik 2	Mbështetje iniciativave biznesore turistike
Drejtimi strategjik 3	Tërheqja e investimeve dhe krijimi i punësimit
Drejtimi strategjik 4	Sigurim hapësirë dhe kualitet jetese
Drejtimi strategjik 5	Zhvillim i fuqisë profesionale punëtore sektoriale
Drejtimi strategjik 6	Kompletimit të Infrastrukturës rurale
Drejtimi Strategjik 7	Krijimi i kushteve për zhvillimin e turizmit rural

VLËRESIMI I KAPACITETEVE INVESTUESE

Kapacitetet investuese janë potencial i financimit të projekteve në sektorin e turizmit rural që ndikojnë në vlerësimet brenda projekteve të natyrës zhvillimore. Në këtë grup bëjnë pjesë edhe investimet për projekte kapitale publike dhe private dhe sidomos është me rëndësi tërheqja e investimeve të huaja direkte në sektorin përkatës. Në këtë kontekst krijimi i PPP që nxit rritjen e punësimit dhe cilësinë e shërbimit është i një rëndësie të veçantë. Aktualisht kapacitetet investuese bazohen në:

Kapacitetet investuese	Problemet	Hapat që synohen
<ul style="list-style-type: none"> ○ Buxhetin komunal, ○ Sektorin privat, ○ Sektorin publik, Burimet natyrore, ○ Kapacitetet e infrastrukturës fizike (ndërtesat), ○ Potencialin njerëzor (rinia). ○ Investimet nga qeveria nacionale ○ Investimet private nga jashtë, Fondet ndërkombëtare, ○ BE dhe donacionet e tjera, ○ Kreditë dhe dhëniet (grantet). 	<ul style="list-style-type: none"> ○ Mungesa e investimeve te huaja direkte ○ Mungesa projekteve atraktive për FDI, ○ Komuna nuk ka një drejtori për turizëm rural dhe FDI, ○ Mungesa e buxhetit, Infrastruktura, ○ Degradimi i resurseve vendore turistike, ○ Degradimi i tokës bujqësore dhe humbja e kësaj veprimtarie. 	<ul style="list-style-type: none"> ○ Krijimi i bazës së qëndrueshme ligjore që lehtëson të bërit biznes, ○ Ngritja e kapaciteteve komunale për promovim dhe tërheqje të investimeve ○ Te përmirësohen politikat fiskale - buxheti dhe investimet ○ Krijimi i një mjedisi të shëndetshëm për punë ○ Krijimi i kushteve për zhvillim ekonomik dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, ○ Krijimi i kushteve për zhvillimin e turizmit dhe komunikimet më të mira, ○ Zbatimi i ligjit për mbrojtje të konsumatorit, ○ Subvencionimi i aktiviteteve të punësimit.

Turizmi rural ne Komunën e Shtimes- sfidat, problemet dhe mundësitë

Shtimja si komunë ka potenciale mjaft të mëdha për zhvillimin e turizmit si kulturor, ashtu edhe të atij natyror dhe rekreativ. Mundësitë për aktivitetet dhe shërbime turistike rurale praktikisht janë pafund. Ato mund të përfshijnë pothuajse çdo gjë që paraqet vlerë, natyrore, klimatike, bimore, kulturore, historike etj.. Kur të shqyrtoni mundësinë për ngritur një biznes turistik në një mjedis rural është e dobishme të bëni një listë të të gjitha aktiviteteve të mundshme për biznesin tuaj të ardhshëm.

Lista e mëposhtme do t'ju ndihmojë të shqyrtoni mundësitë për aktivitete

- Demonstrim i aktiviteteve bujqësore (përpunimi i qumështit, kokërr shirje, kafshët e quajtur, tjerre leshit, qethje e deleve)
- Garat midis kafshëve
- Mbledhje e mollëve
- Shfaqje artistike
- Hedhja e ushqimit
- Hotel me mëngjes
- Shëtitje dhe Biçikleta me qira
- Vëzhgimi i zogjtë
- Shëtitje me varkë , Kanu, Kayaking , Rafting
- Kabin Strehimi dhe Kamping
- Karnavale ose Cirk
- Shërbime ushqimi në dhomë
- Turë në shpella dhe Kampe për fëmijët
- Ndriçimi i Pemës së Krishtlindjeve
- Kurse, vizita, ose demonstrime (bujqësi, aftësi fermeri, Gatim, mbjellje, korje Përgjimin në pemët e panjës
- Çiklizëm malor dhe Koncerte muzikore

- Ngasje automjeti jashtë rrugës
- Zona për blerje me pakicë në ferma
- Paketë udhëtimesh dhe Paint Ball
- Kopsht zoologjik me kafshë të buta
- Fotografi / Piktura dhe Zonë pikniku Shesh lojërash Pikturim kungujsh
- Vjelja kungujve dhe Shitje pjesh freskuese
- Me qira një lope, zgjua bletësh apo pemë
- Tregje në anë të rrugës Ngjitje dhe zbritje shkëmbi Gjueti kafshësh të egra
- Ture ose aktivitete shkollash dhe Ture me vetë ngasje të makinës
- Peshkim, gjueti, etj. Përkrahje komunitetit Bujqësor
- Gara (ushqim, pjekje, ushqime djegëse) Panairi i Artizanatit
- Pritni pemën tuaj të Krishtlindjeve
- Nënproduktet e qumështit
- Tregoni kopshtet (lule, gjelbërim, barëra) Turne edukative ose teknike
- Organizim eventesh (festë ditëlindje, shfaqje me makina, diskutime korporatash, ribashkim familjar, pritje, dasma) Pikturime në fytyrë
- Ferma ose Përvoja e punës në fermë
- Qëndrimi në fermë Tarif peshkimi Tarif gjuetie
- Festivale (sezonale ,i korrjes, ushqimore, pushimesh apo ngjarjesh kulturore)
- Pazar gjërash të lira Loja Ruajtjes ose gjueti Kullotja e dhive
- Ngasje e qerreve dhe Tur me shoqërues tek të mbjellat
- Ecje nëpër shtigje dhe vizitë në muzetë historike dhe vepra të tjera
- Ngasje e kalit
- Organizime sportive dhe turnamente Trajnime dhe konkurse për gjueti me qenë
- Patinazh në Akull dhe Evente të historive të jetuara / Akte
- Kioskë qitjeje (armë zjarri)
- Biznes me specialitet ushqimesh Shesh kërcimi
- Skenë shfaqjesh Tregues historish Zonë për të notuar
- Kantinë vere ose shitje në vendin e prodhimit
- Përvoja me jetën e egër apo
- Vëzhgim i jetës së egër
- Tur në kantina vere ose degustim verërash



Synimet dhe zgjidhjet strategjike për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit rural në Komunën e Shtëmës

Kjo tabelë tregon problemet kryesore në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit rural dhe zgjidhjet e propozuara strategjike.

No.	Problemi	Synimet strategjike dhe zgjidhjet
<i>Problemet me mbrojtje të vlerave turistike dhe natyrore</i>		
1.	Dëmtimi i natyrës	Planifikimi territorial komunal për mbrojtje të peizazhit. Për të subvencionuar prodhimin bujqësor me qëllim për të parandaluar keq menaxhimin e tokave bujqësore dhe për të lehtësuar bizneset e vogla rurale. Për të mbështetur ofruesit e turizmit rural në ndërtimin e ndërtesave nga materialet tipike për rajonin (p.sh., guri, druri). Për të rritur ndërgjegjësimin mjedisor të zyrtarëve komunal dhe ofruesve të turizmit rural.
2.	Dëmtimi i vlerave të florës dhe faunës	Për të zhvilluar dhe zbatuar planet e mbrojtjes së natyrës. Për të edukuar zyrtarët komunalë, ofruesit e turizmit rural dhe turistëve në mbrojtjen e natyrës dhe të diversitetit biologjik.
3.	Kualitet dhe infrastrukturë e dobët në mbrojtje të natyrës	Për të tërhequr fonde të BE - së për financimin e projekteve të cilat zhvillojnë infrastrukturën e mbrojtjes së natyrës dhe ngritjen e kapaciteteve.
4.	Interesat kontradiktore të mbrojtjes së natyrës dhe turizmit	Për të krijuar produkte të reja, me qasje miqësore ndaj natyrës Për të drejtuar lëvizjen e turistëve në drejtim të natyrës miqësore.
5.	Klasifikimi i mbeturinave dhe mungesa e deponive rurale moderne	Përmes stafit komunal dhe projekteve përkatëse të ndikohet tek bizneset për të organizuar mbledhjen e mbeturinave të renditura dhe të ofrimit për riciklimin.
6.	Pamjaftueshmëri e energjisë së ripërtëritshme	Për të nxitur përdorimin e burimeve alternative të energjisë. Izolimi termik i ndërtesave akomoduese turistike.
<i>Kualiteti i dobët i infrastrukturës turistike rurale</i>		
7.	Cilësia e dobët e rrugëve ose traseve për turizëm rural	Për të përdorur fondet strukturore të BE - së për modernizimin e rrjetit rrugor.
8.	Shënjim i pamjaftueshëm i shtigjeve dhe lokacioneve me interes turizmin rural	Përgatitja e stafit për të marrë pjesë në procesin e sistemit të bashkuar shënjit të turizmit rural në nivel lokal dhe regjional. Për të punuar dhe për të nxitur njohjen e shoqatave dhe produktin turistik rural. Për të përfshirë detyrën shënjit në projektet e BE - së.

9.	Infrastruktura e pamjaftueshme në menaxhimin e ujërave	Sigurim qasje në fondet e BE - së ERDF për financimin e projektit. Për të futur masa mbrojtëse për ekonominë e burimeve ujore.
10.	Mosharmonizimi i qendrave të turizmit rural me kërkesat e eko-certifikimit	Futja e masave vullnetare për mbrojtjen e mjedisit. Për të edukuar aktorët turizmit.
<i>Mungesa e informimit dhe ndërgjegjësimit në aktorët e turizmit rural</i>		
11.	Një pjesë e pronarëve të tokës injorojnë parimet bazë të turizmit të qëndrueshëm rural dhe keqpërdorimit të burimeve natyrore	Arritja e mundësisë për të përfshirë pronarët e tokave në zhvillimin e produkteve të mjedisit miqësor ndaj turizmit rural duke respektuar kriteret e cilësisë turistike rurale më të rreptë dhe duke përfshirë edhe kriteret mjedisore në sistemin e cilësisë. Për të nxitur bujqësinë biologjike dhe partnerët e tjerë për përdorimin e qëndrueshëm të tokës. Për të zgjidhur situatat e konfliktit duke përdorur metodat e motivimit.
12.	Një pjesë e ndërmarrjeve turistike mund të zhvillojnë produkte turistike jomiqësore ndaj natyrës turistike	Promovimi i produkteve miqësore ndaj mjedisit turistik Për të kufizuar përhapjen e filozofisë së konsumatorit.
13.	Jo të gjithë palët të interesuara brenda turizmit rural kanë nivele të mjaftueshme të ndërgjegjësimit mjedisor	Organizimi i ngjarjeve të edukimit mjedisor. Prodhimi i materialeve informuese. Promovimi i shembujve pozitivë.
14.	Jo të gjithë aktorët e turizmit rural përpiqen për të përmirësuar vetëdijen e tyre mjedisore	Të implementohet eco - certifikimi
15.	Një pjesë e popullatës lokale nuk janë të gatshëm për të parë të huaj në tokën e tyre private.	Për pronarët e akomodimit rural ngritja e vetëdijes për të përfshirë fqinjët në aktivitetet e turizmit, për ndarjen e të ardhurave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës tek popullata. Për të bashkëpunuar në mënyrë që oferta e turizmit rural të jetë e pasur. Për të shpjeguar përfitimet e bashkëpunimit dhe diferencimin e ofertës nga perspektiva e marketingut për sipërmarrësit rural.

16.	Një pjesë e turistëve kanë filozofinë konsumatorëve që nuk është në përputhje me qëndrimin për të kursyer burimet natyrore	Për të ofruar produkte turistike miqësor ndaj ambientit. Për të shpjeguar vlerën e burimeve natyrore duke treguar për nevojën e kompensimit. Për të rritur çmimin e produkteve turistike antipatik ndaj rrethit.
17.	Ndërgjegjësimi mjedisor i disa individëve ndryshon nga ai i shoqërisë	Të njoh nga afër mysafirët në qendrat e turizmit rural me kërkesat e mbrojtjes së natyrës. Për të kufizuar veprimet që janë të dëmshme për mjedisin.
Problemet në zbatimin e eko-certifikimit		
18.	Vetëm një pjesë e objekteve turistike ose asnjë janë të përfshira në procesin e eko - certifikimit	Të sigurohen përfitime për mbështetjen e qeverisë duke ngritur skemat e eko - certifikimit
19.	Bizneset ankohen në kostot e procesit eco - certifikues	Të promovohet "Certifikata e gjelbër", dhe të mbështetet zbatimi i saj përmes formave të veçanta mbështetëse nga Komuna dhe qeveria. Të bashkëpunohet me eko - etiketën e BE-së "Lulet Evropiane- EU Flowers" dhe shoqatën evropiane të eko-etiketave. Te organizohet marrja e modeleve përmes vizitës, trajnimit etj.

BENEFITET NGA TURIZMI RURAL NË KOMUNEN E SHTIMES

Turizmi rural, aktualisht ende vetëm një treg turizmi pakicë, do të ketë një kontribut të çmuar në ekonomive rurale të Komunës. Kontributi i tij mund të shprehet jo vetëm në aspektin financiar, por edhe në aspektin e vendeve të punës, kontributeve ndaj ruajtjes së mjedisit, traditave, kulturës, dokeve, dhe do jete inkurajim për praktikën e reja të punës dhe injektimi i një vitalitet të ri në ekonominë e përgjithshme komunale. Potencialisht turizmi rural në Komunën e Shtimes premtion disa nga përfitimet e mëposhtme për zhvillimin rural:

o Krijimi i vendeve të punës dhe mbajtje në punë e vendeve aktuale

Flukset e mjeteve monetare rurale turizmit mund të ndihmojnë mbajtjen e vendeve të punës në shërbime të tilla si pakicë, transport, mikpritjen dhe kujdes mjekësor. Ajo gjithashtu mund të sigurojë të ardhura shtesë për fermerët, dhe në disa raste për pylltarët dhe peshkatarët. Krijimi i vendeve të punës të lidhura me turizmin rural zakonisht ndodh të jete i lidhur me hoteleri, tregti, por mund të zhvillohet edhe në transport, aktivitetet të ndryshme në interpretimin e informacionit të trashëgimisë.

o Mundësi të reja biznesi

Turizmi gjeneron mundësi të reja për industrinë, dhe atë në fusha të ndryshme. Edhe ato biznese rurale që jo direkt janë përfshirë në turizëm mund të përfitojnë nga aktiviteti turistik përmes zhvillimit të marrëdhënieve të ngushta me objektet turistike ku ushqime lokale mund të përdoren si pjesë e menysë speciale të turizmit në një lokalitet. Turizmi rural lehtëson zgjerimin e bizneseve plotësuese të tilla si stacionet e shërbimit dhe biznese të reja që janë krijuar që të kujdesen për nevojat turistike për shërbimet e mikpritjes, aktivitete rekreative, art, traditë dhe evente të ndryshme.

- o Mundësitë për Rininë

Industria e turizmit shpesh promovohet si një industri emocionuese dhe në rritje përshtatshme të energjive dhe me entuziazmin e të rinjve. Mundësitë e karrierës në këto raste janë zgjeruar me mundësitë për trajnim dhe përfshirje të drejtpërdrejtë në drejtimin e bizneseve të turizmit, veçanërisht atë të vogël në lokacionin vetanak.

- o Rritje e kërkesës të shërbimit

Shërbimet e informacionit vizitor mund të sigurohen nga degët ekzistuese, të tilla si dyqane, apo pika informacioni enkas të lidhura me turizmin rural. Shërbimet mund të përfitojnë nga konsumatorët shtesë që vizitorët ofrojnë.

- o Diversifikimi Komuniteti

Diversifikimi i komunitetit është një aktivitet i rëndësishëm në shumë zonat kodrinore dhe margjinale rajone. Rajonet pyjore kanë pësuar probleme serioze socio - ekonomike në vitet e fundit, pjesërisht për shkak të prerjeve dhe të përpunimit, dhe pjesërisht për shkak të çmimeve në rënie të kërkesës së drurit. Turizmi rural mund të ndihmojë pylltarinë duke diversifikuar të ardhurat.

- o Turizmi rural rrit dhe rigjallëron krenarinë për Komunitetin

Turizmi inkurajon konformitetin në një imazh ideal të komunitetit që mund të rezultojë në rritjen e krenarisë, lidhjeve personale dhe solidaritetit të komunitetit dhe kështu potenciali i turizmit rural ka implikime pozitive për krenarinë e komunitetit, që mund të shndërrohen në muze të veçantë ruralë si një vend ruajtje e rëndësishme e kulturës rurale.

- o Ruajtja e Kulturës dhe Trashëgimisë Rurale

Në fushën e turizmit rural ndjenja e vendit, trashëgimia, përkatësia dhe kultura e veçante, është një element thelbësor në të dy rastet, tek turistët dhe mikpritësit. Ndjenjat e komunitetit për veçanti, përkatësi trashëgimore e bën zonën tërheqëse për të vizituar dhe të jetuar në të.

- o Rritja e artit dhe vepra artizanale shitje

Arti dhe veprat artizanale do të ketë një vend të veçantë në trashëgiminë kulturore të rajoneve brenda komunës.

Është e ditur botërisht se turizmi mund të ndihmojë artin dhe veprat artizanale, përmes organizimit të festivaleve, panairove dhe me blerjen e produkteve artizanale. Mbështetja në mes të artit dhe turizmit mund të jetë një proces i dyanshëm.

- o Konservimi të peizazhit

Konservimi i peizazhit bëhet një formë gjithnjë e më e rëndësishme e mbrojtjes së trashëgimisë. Peizazhi është i një rëndësie të veçantë për turizmin rural, por, në mënyrë të barabartë, përdorimi i tij si mjet atraktues për vizitor është jetik. Industria e konservimit të peizazhit dhe përdorimi nga vizitor sjell përfitime politike po ashtu mund të sjellë edhe përfitime ekonomike.

- o Përmirësimet mjedisore

Përmirësimet mjedisore të tilla si avancim infrastrukture në fshat dhe rregullimin e komunikacionit, ujërat e zeza dhe hedhja e mbeturinave mund të ndihmohet nga të ardhurat e turizmit dhe këto kontribuojnë në mbajtjen e një mjedisi të pastër që ndihmojnë zhvillimin e krenarisë për vendin. Ky fakt është po ashtu i rëndësishëm në mbajtjen e popullsisë ekzistuese dhe bizneseve lokale dhe në tërheqjen e ndërmarrjeve të reja dhe familjeve.

- o Mjedisi historik i ndërtuar

Mjedisi historik i ndërtuar mund të përfitojnë nga turizmi rural në disa mënyra. Shumë prona historike tani mund të trajtohen dhe restaurohen edhe në bazë të fondeve të shumëfishta ku edhe turizmi rural kontribuon.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE NË FUSHËN E TURIZMIT RURAL TË KOMUNËS SË SHTIMES

Periudha kohore dhe objektivat strategjike për vizionin e komunës është dhënë për 4 vitet e ardhshme. Këto objektiva strategjike janë themeli i procesit për zhvillimin e turizmit rural të komunës së Shtimes. Objektivat strategjike janë formuluar si një mundësi reale për periudhën që pritet dhe në thelb përfshijnë:

- o *Ngritjen e vetëdijes dhe njohjen e rëndësisë së turizmit rural për zhvillim dhe impakt pozitivë në ekonominë lokale*
- o *Përmirësimi i kushteve dhe cilësisë së jetës së banorëve të zonës*
- o *Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit rural dhe rritja e punësimit*
- o *Krijimi i mjedisit të favorshëm për investime dhe stimulimin e bashkëpunimit mes sektorëve publik dhe privat(PPP)*

	Objektivat	Masat
1	<i>Ngritjen e vetëdijes dhe njohjen e rëndësisë së turizmit rural për zhvillim dhe impakt pozitiv në ekonominë lokale</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Aktivitete të ndryshme vetëdijesuese</i> 2. <i>Dëgjime, takime dhe shpërndarje e materialeve si fletëpalosje, broshura, harta, raporte</i> 3. <i>Përpilimi i hartës elektronike të Shtimes me synim promovimin e turizmit</i> 4. <i>Identifikimi i tregjeve potenciale</i> 5. <i>Katalogizimi i atraksioneve turistike të zonës</i> 6. <i>Digjitalizimi i informacionit turistik</i> 7. <i>Nxitja dhe përkrahja e operatorëve turistik për promovimin</i> 8. <i>Promovimi i produkteve tradicionale, kulturës, historisë, zonave specifike bujqësore, etj.</i> 9. <i>Zgjerimi dhe përmirësimi i produktit turistik</i>
2	<i>Përmirësimi i kushteve dhe cilësisë së jetës së banorëve të zonës</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Avancimi i infrastrukturës në zonat turistike rurale</i> 2. <i>Zhvillimi i pakove turistike për frekuentuesit e turizmit rural (ture në zonat rurale/malore).</i> 3. <i>Zhvillimi i produktit turistik për vizitorët e huaj, të interesuar në turizmin malor, kulturor, historik dhe të aventurës.</i> 4. <i>Zbatimi i Programit për Zhvillimin e Sistemit të Menaxhimit të Mbeturinave</i> 5. <i>Pastrimi Zonës dhe rregullimi i shtigjeve</i> 6. <i>Pyllëzimi i Grykës së Llanishtit dhe Carralevës</i>
3	<i>Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit rural dhe rritja e punësimit</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Lobim dhe mbështetje për komunitetin drejt krijimit të shtëpive pritëse</i> 2. <i>Lobim për mbështetje nga fondet qeveritare dhe donatorë</i> 3. <i>Nxitja e bizneseve për investime dhe shërbime brenda standardeve.</i> 4. <i>Mbështetja e prodhimeve tradicionale & bio.</i> 5. <i>Përmirësimi i ambientit përgjatë zonave rurale turistike</i> 6. <i>Ndërtimi i rrugëve turistike</i> 7. <i>Avancimi i kapaciteteve njerëzore të bizneseve që ofrojnë shërbime turistike.</i> 8. <i>Adaptim i arsimit adekuat</i>

4	Krijimi i mjedisit të favorshëm për investime dhe stimulimin e bashkëpunimit mes sektorëve publik dhe privat (PPP)	<ol style="list-style-type: none"> 1. Zhvillimi dhe rishikimi i planeve të zhvillimit territorial me fokus turizmin rural 2. Zotimi publik i qeverisjes lokale dhe aktorëve të tjerë drejt zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit 3. Ndërgjegjësimi i qeverisjes vendore dhe bizneseve për përfitimet që sjell zhvillimi i turizmit rural. 4. Këshilla për bizneset e turizmit rural dhe ndihma në përgatitjen e projekt propozimeve për tërheqje fondesh 5. Lobimi avancim ne zbatimin e legjislacionit ekzistues dhe formësim i mëtëjmë i tij drejt lehtësimit për investim ne këtë fushe
---	--	---

PALET E INTERESIT PËR STRATEGJINË E ZHVILLIMIT EKONOMIK TË KOMUNËS SË SHITES

Kush e përbën këtë grup të ndryshëm të përfshirë në zhvillimin e turizmit në komunitet? Kush duhet të përfaqësohet?

Spektori privat - Pronarët e bizneseve / operatorët; Shoqatat e tregtarëve; Shoqatat turistike dhe hoteliere (motele, restaurante; bujtina), institucionet e kreditimit; planifikuesit e peizazhit turistik etj.

Spektori Publik - Pushteti lokal, zyrtarët të qeverisë nacionale; bordet e planifikimit apo të stafit; departamentet ekonomike, komuniteti, organizatat e zhvillimit rajonal dhe lokal, agjencitë shtetërore për parqet, pyjet, agjencitë rekreative; shoqëritë historike, dhe qytetarët e interesuar.

Kuazi Spektori Publik - Bordet joformale të organizatave turistike, këshillat apo organizatat promovuese dhe në mënyrë të veçante sponsorët ose producentët e ngjarjeve kulturore, artizanale, historike etj..

LISTA E PROJEKTEVE DHE LIDHJA ME OBJEKTIVAT, AFATET DHE PALËT E INTERESIT

OBJEKTIVA 1				
NGRITJEN E VETËDIJES DHE NJOHJE E RËNDËSISË SË TURIZMIT RURAL PËR ZHVILLIM DHE IMPAKT POZITIV NE EKONOMINË LOKALE;				
MASAT	PROJEKTET/ AKTIVITETET	PALËT	KOHA E REALIZIMIT	KOSTO (Euro)
1. Aktivitete të ndryshme vetëdijesuese	<i>1.1. Projekti për njoftimin e komunitetit rreth mundësive të turizmit rural në Shtime</i>	<i>DZHE, OJQ, Donatorët</i>	2016	5000
	<i>1.2. Trajnim për zyrtar komunal dhe për ofruesit e turizmit rural dhe turistëve në mbrojtjen e natyrës dhe të diversitetit biologjik.</i>	<i>DZHE, OJQ, Donatorët</i>	2016	5000
	<i>1.3. Organizimi i ditës së aktivitete për promovimin e produkteve turistike miqësore ndaj ambientit</i>	<i>DZHE, OJQ, Donatorët</i>	2016	3000
2. Dëgjime dhe takime dhe shpërndarje e materialeve si fletëpalosje, broshura, harta, raporte	<i>1.1. Përgatitja dhe shpërndarja e broshurës turistike rurale për Komunën e Shtimes</i>	<i>DZHE, OJQ, Donatorët</i>	2016	3000
	<i>1.2. Përgatitja, botimi dhe shpërndarja e hartës me produkte dhe pika turistike të Komunës së Shtimeve</i>	<i>DZHE, OJQ, Donatorët</i>	2016	3000
	<i>1.3. Organizimi i ditës së turizmit rural për Komunën e Shtimes</i>	<i>DZHE, OJQ, Donatorët</i>	2016	2500
3. Përpilimi i hartës elektronike të Shtimes me synim promovimin e turizmit	<i>1.1. Projekti për identifikim e të gjitha pikave të veçanta turistike rurale në Komunën e Shtimes</i>	<i>DZHE, OJQ, Donatorët</i>	2016	2000
	<i>1.2. Projekti i digjitalizimit të pikave të mësipërme dhe përgatitja e hartës digjitale</i>	<i>DZHE, OJQ, Donatorët</i>	2016	3000
4. Identifikimi i tregjeve potenciale	<i>1.1. Projekti për hulumtimin e turistëve potencial vendor</i>	<i>DZHE, OJQ, Donatorët</i>	2016	2500
	<i>1.2. Projekti për prezantimin e hot sportive turistike të Shtimes në regjion</i>	<i>DZHE, OJQ, Donatorët</i>	2016	3000
	<i>1.3. Projekti për njohje të zonës turistike të Shtimes nga operatorët e huaj turistik</i>	<i>DZHE, OJQ, Donatorët</i>	2016	3000
5. Katalogizimi i atraksioneve turistike të zonës	<i>1.1. Përgatitja e katalogut turistik të Shtimes</i>	<i>DZHE, OJQ, Donatorët</i>	2016	4000
	<i>1.2. Promovimi i katalogut turistik në vend dhe regjion</i>	<i>DZHE, OJQ, Donatorët</i>	2016	2500

6. Digjitalizimi i informacionit turistik	1.1. Ndërtimi i web portalit digjital për turizmin në Shtime	DZHE, OJQ, Donatorët	2016	5000
	1.2. Përgatitja e video spotit reklamues për turizmin rural dhe benefitet	DZHE, OJQ, Donatorët	2016	3000
7. Nxitja dhe përkrahja e operatorëve turistik për promovimin	1.1. Organizimi i 3 Workshopeve rreth turizmit rural dhe mundësive në Shtime	DZHE, OJQ, Donatorët	2016	5000
	1.2. Organizimi i konkursit për kompaninë turistike të dalluara	DZHE, OJQ, Donatorët	2017	2000
	1.3. Projekti për grante për kompanitë me 3 e më shumë të punësuar	DZHE, OJQ, Donatorët	2017	10000

OBJEKTIVA 2

PËRMIRËSIMI I KUSHTEVE DHE CILËSISË SË JETËS SË BANORËVE TË ZONËS

MASAT	AKTIVITETET	PALËT	KOHA	KOSTO
1. Avancimi i infrastrukturës në zonat turistike rurale	1.1. Ndërtimi i rrugës Petrovë - Topillë	DPUKGJ, MI, Donatorë	2018	750000
	1.2. Restaurimi i mullirit të ujit të Roshajve në Mollopolc,	DK, MK, Donatorë	2016	10000
	1.3. Restaurimi i mullirit të ujit të familjes Jakupi në Reçak	DK, MK, Donatorë	2017	10000
	1.4. Restaurimi i mullirit të ujit të familjes Veseli në Llanishtë	DK, MK, Donatorë	2018	10000
	1.5. Restaurimi i mullirit të ujit të Fekajve në Carralevë,	DK, MK, Donatorë	2018	10000
	1.6. Restaurimi i shtëpive të vjetra në Topillë, Reçak, Carralevë, Karaçic, Rancë etj	DK, MK, Donatorë	2019	150000
	1.7. Restaurimi i objekteve të ish shkollave në Llanisht, Topillë, Rancë dhe Karaçicë dhe ridestinimi I tyre	PPP	2017	1000000
	1.8. Restaurimi i Kështjellës Mesjetare "Guri i Shtrenjtë"	DK, MK, Donatorë	2019	300000
	1.9. Restaurimi i Kalasë së Petrovës - "Lugu i Gjyetit"	DK, MK, Donatorë	2019	300000
	1.10. Kultivimi i peshkut, shitja dhe ofrimi produkteve të tij në restaurant - "Mas Shpelle" në Devetakë	PPP	2016	74300
	1.11. Rregullimi i Shpellës së "Imer Devetakut" dhe Shpellës së Pjetërshiticës	DK, MK, Donatorë	2019	250000
	1.12. Shenjëzimi, ruajtja dhe restaurimi i vendeve dhe shtëpive të luftës së UÇK - së	DK, dhe MK	2017	100000

	<i>1.13. Shenjëzimi, ruajtja dhe restaurimi i vendeve dhe shtëpive të trashëgimisë kulturore dhe historike</i>	<i>DK dhe MK</i>	2017	80000
	<i>1.14. Rregullimi i burimeve të ujit në Grykën e Llanishtit dhe Grykën e Carralevës</i>	<i>DPUKGJ, MK, Donatorë</i>	2018	150000
2. Zhvillimi i pakove turistike për frekuentuesit e turizmit rural (ture në zonat rurale/malore).	<i>1.1. Projekti për demonstrimin e aktiviteteve agroturistike (përpunimi qumështit, korrja me dorë, shirja, qethja e deleve)</i>	<i>DK, MK, Donatorë</i>	2017	3500
	<i>1.2. Projekti për zonën e produkteve te gatimit tradicional</i>	<i>DK, MK, Donatorë</i>	2017	3000
3. Zhvillimi i produktit turistik për vizitorët e huaj, të interesuar në turizmin malor, kulturor, historik dhe të aventurës.	<i>1.1. Ngritja e tre kopshteve zoologjike me kafshë të buta dhe të egra</i>	<i>DK, MK, Biznesi, Donatorë</i>	2017	15000
	<i>1.2. Organizimi i panairit të artizanatit vendor</i>	<i>DK, Biznesi, Donatorët</i>	2016	7500
	<i>1.3. Projekti shkollor - të njohim vendin - ecje shtigjeve të lirisë</i>	<i>DA, MASHT, OJQ</i>	2016	2500
	<i>1.4. Organizimi i ditës së sporteve popullore - mundje, tërheqje litari, gjuajtje guri</i>	<i>DK, MK, OJQ rinore</i>	2016	4000
4. Zbatimi i Programit për Zhvillimin e Sistemit të Menaxhimit të Mbeturinave	<i>1.1. Pastrimi gjeneral i deponive ilegale në viset Malore</i>	<i>DSHP, MMPH, Donatorët</i>	2017	150000
	<i>1.2. Pastrimi gjeneral i deponive ilegale në Shtime dhe fshatrat e Rrafshit</i>	<i>DSHP, MMPH, Donatorë</i>	2018	180000
	<i>1.3. Projekti për trajnim të ofruesve të shërbimeve turistike rurale për trajtim të mbeturinave</i>	<i>DSHP, Donatorë, OJQ</i>	2016	10000
5. Pastrimi Zonës dhe rregullimi i shtigjeve	<i>1.1. Rregullimi i shtigjeve Petrovë - Llanisht - Devetakë</i>	<i>DPUKGJ, Donatorë</i>	2016	450000
	<i>1.2. Rregullimi i shtigjeve Carralevë - Dugë - Karaçicë</i>	<i>DPUKGJ, Donatorë</i>	2017	450000
	<i>1.3. Rregullimi i shtigjeve Carralevë - Rancë</i>	<i>DPUKGJ, Donatorë</i>	2018	100000
	<i>1.4. Rregullimi i shtigjeve përgjatë lumit në Shtime, Carralevë, Mollopolc - Vojnovc</i>	<i>DPUKGJ, Donatorë</i>	2016	480000
	<i>1.5. Rregullimi i shtigjeve deri te Shpella e Imer Devetakut dhe Shpella e Pietërshticës</i>	<i>DPUKGJ, Donatorë</i>	2017	50000
6. Pyllëzimi i Grykave dhe hapësirave turistike	<i>1.1 Pastrimi, rrallimi dhe pyllëzimi në Rajonin e Grykës së Llanishtit</i>	<i>DZHE, MBPZHR</i>	2016	20000
	<i>1.2 Pastrimi, rrallimi dhe pyllëzimi në Rajonin e Grykës së Carralevës</i>	<i>DZHE, MBPZHR</i>	2016	20000

OBJEKTIVA 3

ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM I TURIZMIT RURAL DHE RRIJTJA E PUNËSIMIT

MASAT	AKTIVITETET	PALËT	KOHA	KOSTO
1. Lobim dhe mbështetje për komunitetin drejt krijimit të shtëpive pritëse	<i>1.1. Rregullimi i Qendrës Informative në Luzhak</i>	<i>DK, MK, Donatorë</i>	2017	10000
	<i>1.2. Rregullimi i Qendrës Informative në Carralevë</i>	<i>DK, MK, Donatorë</i>	2017	10000
	<i>1.3. Rregullimi i Qendrës Informative në Parkun e Pishave në Shtime</i>	<i>DK, MK, Donatorë</i>	2016	100000
	<i>1.4. Trajnim i komunitetit për organizim të ofertës turistike</i>	<i>DZHE, Biznesi, Donatorë</i>	2016	7000
2. Lobim për mbështetje nga fondet qeveritare dhe donatorë	<i>1.1. Ngritja dhe funksionalizimi i Sektorit për promovimin e Turizmit Rural</i>	<i>DZHE</i>	2016	10000
	<i>1.2. Shpërndarja e broshurave në Kosovë dhe jashtë saj</i>	<i>DZHE, MTI, Donatorë</i>	2017	10000
3. Nxitja e bizneseve për investime dhe shërbime brenda standardeve	<i>1.1. Dhënia në shfrytëzim e pronës komunale</i>	<i>KK</i>	2016 - 2019	0
	<i>1.2. Ofrimi në dispozicion i broshurave dhe web faqes së internetit të komunës</i>	<i>DZHE, DK dhe ZI</i>	2016 - 2019	5000
	<i>1.3. Krijimi i lehtësirave fiskale aty ku ka mundësi</i>	<i>Komuna, MAPL</i>	2016 - 2019	1000
	<i>1.4. Trajnimi i investitorëve potencial për të aplikuar për grante</i>	<i>DZHE, DPUKGJ Biznesi, Donatorë</i>	2016 2017 2018	15000
	<i>1.5. Workshop për përgatitje të biznes planeve për turizëm rural</i>	<i>DZHE, DPUKGJ Biznesi, Donatorë</i>	2016	5000
4. Mbështetja e prodhimeve tradicionale & bio	<i>1.1. Projekti për përpilimin e produkteve tradicionale dhe katalogizimi i tyre</i>	<i>DK, DZHE, biznesi, Donatorët</i>	2016	3000
	<i>1.2. Organizimi i panairit për produkte tradicionale</i>	<i>DK, DZHE, Biznesi, Donatorë</i>	2016 - 2019	5000
5. Përmirësimi i ambientit përgjatë zonave rurale turistike	<i>1.1. Projekti për shënjimin e zonave turistike rurale</i>	<i>DPUKGJ, biznesi, Donatorë</i>	2017	3000
	<i>1.2. Vendosja e rregullatives ligjore për ruajtje të këtyre zonave</i>	<i>KK, Qeveria</i>	2016 - 2019	1000
6. Avancimi i kapaciteteve njerëzore të bizneseve që ofrojnë shërbime turistike	<i>1.1. Organizimi i ditës së turizmit rural në Shtime</i>	<i>DZHE, Biznesi, Donatorë</i>	2016	3000
	<i>1.2. Trajnimi për gratë që kryejnë punë artizane rreth mundësisë së përfitimt të tyre</i>	<i>DK, Biznesi, Donatorë</i>	2016	7000
	<i>1.3. Mbështetja e operatoreve turistik për njohje me eksperiencat e mira</i>	<i>DZHE, Biznesi, Donatorë</i>	2017 - 2019	2000
8. Adaptim i arsimit adekuat	<i>1.1. Hapja e Drejtimit për Turizëm Rural në SHMP</i>	<i>DA dhe MASHT</i>	2017 - 2018	200000

	1.3. Trajnimi i stafit të operatorëve dhe ofruesve të turizmit rural	DZHE, Biznesi, Donatorë	2017 - 2019	5000
	1.4. Ndarja e bursave për student të degës së turizmit	DA, Biznesi, Donatorë	2017 - 2019	5000

OBJEKTIVA 4

KRIJIMI I MJEDISIT TË FAVORSHËM PËR INVESTIME DHE STIMULIMIN E BASHKËPUNIMIT MES SEKTORËVE PUBLIK DHE PRIVAT (PPP)

MASAT	AKTIVITETET	PALËT	KOHA	KOSTO
1. Zhvillimi dhe rishikimi i planeve të zhvillimit territorial me fokus turizmin rural	1.1. Hartimi i planit implementues për zhvillimin e turizmit rural bazuar në Strategjinë përkatëse	DZHE dhe DK	Janar - Mars 2016	10000
	1.2. Hartimi i projekteve për 3 zona turistike që do dalin nga Plani implementues	DPUKGJ, DZHE, Konsulentë	2016 - 2017	5000
	1.3. Rishikimi i planeve rregulluese me theks tek zonat turistike	Komuna, Konsulentë	2016 - 2017	5000
2. Zotimi publik i qeverisjes lokale dhe akterëve të tjerë drejt zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit	1.1. Vendosi në prioritetet qeverisëse e fushës së turizmit rural	Komuna	2016	500
	1.2. Ndarja e granteve dhe trajnimit për aplikimin për grante nga komuniteti	Komuna, Biznesi, Donatorët	2016 - 2019	5000
3. Ndërgjegjësimi i qeverisjes vendore dhe bizneseve për përfitimet që sjell zhvillimi i turizmit rural.	1.1. Workshope informuese në periudhë çdo 6 mujore për zyrtarë dhe ofrues turizmi rural	Komuna, Biznesi, Donatorë	2016 - 2017	7500
	1.2. Binjakëzimi me lokalitete si motra në regjion	Komuna, biznesi, Donatorë	2016 - 2019	6000
4. Këshilla për bizneset e turizmit rural dhe ndihma në përgatitjen e projekt propozimeve për tërheqje fondesh	1.1. Organizimi i konsulencës për 20 biznese për ide ndërmarrësie	Komuna, Biznesi, Donatorë	2016	10000
	1.2. Organizimi i trajnimit për përgatitje të projekt propozimeve për grante nga KE, USAID etj.	Komuna, biznesi, Donatorë	2016	10000
5. Lobim dhe avancim në zbatimin e legjislacionit ekzistues dhe formësimi i mëtëjnë i ij drejt lehtësimit për investim në këtë fushë	1.1. Hartimi i Rregullores për Turizmin Rural	DZHE, KK	2018	1000
	1.2. Hartimi i rregullores për Eko - Certificate të objekteve turistike	DZHE, KK	2018	1000

MONITORIMI DHE VLERËSIMI - MONITORIMI I PERFORMANCËS - REALIZIMIT TË PROJEKTEVE

Monitorimi

Strategjia e Zhvillimit të turizmit rural në Komunën e Shtimes do të monitorohet nga ekipi i Zhvillimit të sektorit të turizmit rural dhe përfaqësues të shoqërisë dhe sektorit të biznesit nga fusha e turizmit rural. Ekipi do të:

- **R**ishikoj në bazë vjetore të arriturat dhe sfidat për të gjetur mënyra për të përmirësuar shërbimet e Komunës, për të monitoruar aktivitetin e biznesit dhe të identifikojë ndonjë pengesë të konsiderueshme për investime.
- **S**igurimi i raporteve vjetore të progresit për të matur Zbatimin e Strategjisë. Çdo objektivi në Strategji do kompletohet me një përfundim të përcaktuar. Si pjesë e procesit të raportimit këto rezultate do të vlerësohen për të siguruar se ato janë dorëzuar në kohë të përshtatshme dhe çdo bllokim apo pengesë eventuale e rrugëve për arritjen e veprimeve do të identifikohen dhe jepen mënyrat e rekomanduara për të ecur përpara.

Vlerësimi

Strategjia e zhvillimit të turizmit rural mendohet të jete storie suksesi që do ndikoj për një ekonomi të qëndrueshme lokale; ku ndërhyrja lokale është mbështetur; ku rritja e vendeve të punës dhe mundësive lokale të punësimit tejkalojnë mesataren vendore, ku turizmi rural dhe mjedisi natyror nuk është komprometuar nga rritja ekonomike; ku investimi është mirëpritur dhe ndihmuar.

Përderisa një seri e objektivave dhe veprimeve janë paraqitur në kuadër të strategjisë ato do të maten me progresin e arritur kundrejt qëllimeve parësore të strategjisë. Realizimi i objektivave do të matet në kuadër të Planit Implementues i cili duhet të përgatitet jo më larg se 3 muaj pas miratimit të Strategjisë.

ANNEX

10 udhëzime për një biznes të mire në fushën e turizmit rural

1. Klientët janë njerëzit më të rëndësishëm në çdo biznes
2. Klientët nuk varen prej nesh - ne varem prej tyre
3. Klientët nuk përbëjnë pengesë në punën tonë - ata janë qëllimi i saj
4. Klientët na bëjnë favor kur na telefonojnë - ne nuk ju bëjmë ndonjë favor duke ju shërbyer atyre
5. Klientët janë pjesë e biznesit - ata nuk janë persona të huaj që nuk i interesojnë biznesit
6. Klientët nuk janë thjesht shifra statistikore - ata janë qenie të gjalla me ndjenja dhe emocione
7. Klientët janë jeta e fermës, frymëmarrja e biznesit
8. Klientët janë ata të cilët përcjellin dëshirat e tyre tek ne - është detyra jonë t'i plotësojmë ato
9. Klientët janë ata që meritojnë mirësjellje dhe trajtim të vëmendshëm
10. Klientët janë ata me të cilët nuk duhet të debatojmë dhe duhet të jemi mikpritës.